



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORE
ZYRA PROTOKOLL-ARKIVËS
Nr. 82/3 Prot.
Datë: 14.01.2020

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më 09.01.2020

VENDIM

Nr. 3, datë 9.01.2020

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLOREVE TË PROGRAMEVE TË CIKLIT TË DYTË TË
STUDIMEVE: "MASTER PROFESIONAL NË ADMINISTRIM PUBLIK", "MASTER
PROFESIONAL NË MARKETING", "MASTER PROFESIONAL NË SIPËRMARRJE DHE
TURIZËM"**

Mbështetur në shkronjën d të pikës 1 në nenin 38 në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", shkronjën dh të pikës 1 në nenin 19 në Statutin e UV-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 9.01.2020

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren e programit të ciklit të dytë të studimeve "Master profesional në administrim publik" (bashkëlidhur).
2. Të miratojë rregulloren e programit të ciklit të dytë të studimeve "Master profesional në marketing" (bashkëlidhur).
3. Të miratojë rregulloren e programit të ciklit të dytë të studimeve "Master profesional në sipërmarrje dhe turizëm" (bashkëlidhur).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

RREGULLORE E PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT

“MASTER PROFESIONAL” në “ADMINISTRIM PUBLIK”

Departamenti i Biznesit

Dhjetor 2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK**

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Baza ligjore**

Kjo rregullore bazohet në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Udhëzimin e MASR, për çeljen e Programeve të Studimit, Statutit (2019) dhe Rregullores (2014) të Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës.


**Neni 2
Misioni dhe objektivat**

- a) Rregullorja synon të krijojë një kuadër të plotë dhe të qartë për programin e ciklit të dytë të studimit "Master Profesional" në "Administrim Publik", si dhe të përcaktoj rregulla standarte të përgatitjes, organizimit dhe administrimit të studentëve të këtij cikli.
- b) Kjo rregullore i bashkangjitet Rregullores së Brendshme të Departamentit të Biznesit dhe shtrin efektin e saj mbi njësinë mësimore – shkencore përgjegjëse për organizimin e Programit të Ciklit të dytë "Master Profesional" në "Administrim Publik".
- c) Ky program studimi përfshihet në ciklin e dytë të studimeve universitare të ofruara prej Departamentit të Biznesit, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë dhe siguron Diplomë Universitare "Master Profesional" në "Administrim Publik".

**KREU II
ORGANIZMI I PROGRAMIT TE STUDIMIT**

**Neni 3
Programi i studimit**

Programi i studimit "Master Profesional" në "Administrim Publik" siguron Diplomë Universitare "Master Profesional" në "Administrim Publik". Ky program organizohet dhe shprehet përmes grumbullimit të krediteve sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS). Për të fituar këtë diplomë nevojiten 60 kredite (ECTS). 60 kredite (ECTS) përfaqësojnë ngarkesën e punës së një viti akademik studimesh, aq sa është edhe kohëzgjatja e këtij programi studimesh.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- a) Viti akademik është njësia kohore bazë e studimeve. Një vit akademik përbëhet nga 2 semestra dhe shtrihet në intervalin nga 30 deri 40 javë mësimore, sipas udhëzimeve MASR (30 javë mësim dhe 6-8 javë provime dhe provim formimi / mbrojtje teze diplome). Fillimi dhe përfundimi i vitit akademik përcaktohet me Udhëzim të MASR në çdo fillim viti akademik.
- b) Çdo semestër zgjat 15 javë për mësim dhe mesatarisht 3-4 javë për provime. Organizimi i vitit akademik, datat e fillimit të semestrave dhe sezoni i provimeve, shpallen nga rektori në fillim të viti akademik.
- c) Në fillim të çdo viti akademik, mbështetur në kurrikulat e programeve të studimit, departamentet përcjellin planin mësimor për miratim tek Dekani i Fakultetit dhe Rektori. Për çdo kurs hartohen programet mësimore (syllabus).
- d) Me fillimin e vitit akademik, Departamenti shpall orarin mësimor: ditën, orën, sallën dhe personelin akademik përkatës, për semestrin përkatës.
- e) Moduli themelor i studimit është lënda semestrale me kredite (ECTS) të bashkangjitura në planin mësimor të miratuar të programit të studimit.
- f) Numri i caktuar i kredive fitohet pas përfundimit me sukses të disiplinës, siç është përshkruar në këtë Rregullore dhe në Rregulloren e Brendshme të Universitetit.
- g) Vlerësimi i studentëve bëhet nga personeli akademik përkatës që zhvillon disiplinat mësimore, i cili organizon sipas gjykimit të tij kontrole me gojë, me shkrim, ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë, detyra të pavarura, detyra kursi etj., në përputhje me mënyrat e vlerësimit të përcaktuara në këtë Rregullore dhe në Rregulloren e Brendshme të Universitetit.
- h) Studenti përfundon studimet në këtë program studimi dhe merr diplomë kur ka likujduar me sukses gjithë disiplinat mësimore të parashikuara në planin mësimor përkatës, ka mbrojtur me sukses tezën e diplomës / provimin e formimit, kjo në varësi të notës mesatare që arrin studentin gjatë të dy semestrave të studimit, dhe ka fituar 60 kredite (ECTS). Këto dy forma vlerësimi përmbajnë tematika të lëndëve të drejtimit që ka ndjekur në program, me qëllim krijimin dhe vlerësimin e dijeve të fituara në disiplina të ndryshme.

i. Tematika e temës së diplomës

Tema e diplomës mund të jetë bibliografike, kërkimore apo dhe kombinim i të dyjave për çështje që lidhen me disiplinat mësimore të planit mësimor të programit të studimit.

Miratimi i udhëheqësit të diplomës dhe fushës së studimit bëhet në departament me propozim të udhëheqësit pasi ky i fundit ka diskutuar dhe dakortësuar me studentin.

Zgjedhja e temës së diplomës duhet të bëhet nga studentin dhe të jetë aprovuar nga udhëheqësi i tij/saj shkencor.

Realizimi me sukses i punimit kërkon angazhim maksimal të studentit, i cili duhet të zhvillojë kontakte të vazhdueshme dhe të raportojë në mënyrë sistematike tek udhëheqësi punën e kryer sipas një skeduli të përcaktuar paraprakisht.

Tema e diplomës duhet të përfaqësojë një punë kërkimore shkencore origjinale dhe të mos jetë paraqitur në ndonjë institucion tjetër arsimor.

Studenti duhet të përcaktojë qartë metodologjinë kërkimore (induktive apo deduktive) të studimit në varësi të kontekstit të studimit.

Struktura e temës duhet të jetë e qartë dhe duhet të zbatohet pavarësisht tipit të metodologjisë së përzgjedhur në të.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Përmbajtja e temës së diplomës duhet të paraqesi një vështrim të literaturës së huaj dhe të asaj vendase, e cila tregon se studenti e njeh mirë fushën e tij kërkimore dhe është në gjendje të paraqesi koncepte teorike, të analizojë dhe të krahasojë zhvillimin e modeleve teorike nga autorë të huaj apo vendas.

Gjithashtu, vështrimi i literaturës duhet të përmbajë paraqitje dhe krahasime të rezultateve të punimeve empirike të autorëve të huaj dhe vendas të kohëve më të fundit dhe të pasqyrojë hendequn që ekziston në literaturë nën kontestin e vendit tonë.

Një pasqyrë e përgjithshme e variablave të marrë në studim duhet të bëhet për Shqipërinë për të evidentuar dhe kuptuar më mirë ecurinë e variablave në kohë dhe evidentimin e problematikave të tyre (nëse ka).

Zgjedhja e tipit të të dhënave dhe aplikimi i metodave të duhura kërkimore është një mundësi për të dëshmuar pjekurinë e tij/saj akademike dhe aftësinë për të aplikuar punë kërkimore në të ardhme.

Mbyllja e punimit kërkimor shkencor realizohet me nxjerrjen e konkluzioneve dhe dhënien e sugjerimeve për grupet e ndryshme të interesit.

Shkrimi i temës së diplomës i mundëson studentit të mësojë gjëra të reja për veten e tij/saj, për shembull, për kapacitetin, perceptimin, kreativitetin, këmbënguljen dhe mënyrën e të punuarit.

ii. Forma dhe volumi i tezës së diplomës

Punimi i diplomës për ciklin e dytë të studimit Master Profesional duhet të ketë një numër faqesh minimalisht prej 50 faqe. Kriteret e punimit të temës së diplomës dhe formati i saj duhet të jetë konform Vendimit të Këshillit të Fakultetit me Nr 190 Prot datë 02.07.2014.

iii. Diagrama kohore

Studentit që i lind e drejta për tu diplomuar me temë diplome, në fillim të semestrit përkatës, por jo më vonë se java e dytë, aplikon në sekretari për temë diplome duke plotësuar një formular ku propozon udhëheqësin e temës së diplomës. Ky i fundit miratohet nga drejtuesi i departamentit jo më vonë se java e katërt. Udhëheqësi i diplomës dorëzon një deklaratë ku të dy palët (udhëheqësi dhe studenti) kanë rënë dakort për të punuar së bashku mbi fushën e studimit të përzgjedhur, jo më vonë se java e tretë e semestrit. Afati i dorëzimit të punimit të temës së diplomës është një javë para datës së provimit të diplomës.


iv. Detyrime të pedagogut udhëheqës

- Të dorëzojë në kohë propozimet për studentët që merr përsipër të udhëheqë, si dhe fushën e studimit..
- Orientime dhe takime këshilluese në periudha të rregullta kohore me studentët. T'u ofrojë studentëve udhëzime për shkrimin dhe mbrojtjen e temës si dhe për vlerësimin e saj.

v. Vlerësimi

- Tema e diplomës vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash përpara një komisioni të ngritur në Departament.

i) Kohëzgjatja maksimale e studimeve nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimit që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën kur student i



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

ka pezulluar studimet. Studenti mund të përfundojë studimet e plota dhe të mbrojë diplomën, brenda afatit të rregullt të studimeve ose tej kufirit që parashikon ky afat, por duke iu nënshtruar detyrimeve që lindin nga kohëzgjatja e studimeve përtej kohës normale.

- j) Bazuar në Nenin 45 "Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies" të Rregullores së Universitetit, në ciklin e dytë të studimeve master, semestret e vjeshtës dhe pranverës kanë të njëjtën kohëzgjatje, por me specifikën që programi i një disipline mund të realizohet jo domosdoshmërisht për një periudhë 15-javore, bazuar në burimet njerëzore të brendshme dhe të jashtme që ofron universiteti dhe në varësi të kushteve të tjera. Kjo nënkupton që plani mësimor semestral mund realizohet, duke bërë një organizim të mësimdhënies dhe shpërndarje të disiplinave përgjatë tij, që do të thotë se mësimdhënia në një disiplinë mund të fillojë në një nga javët e semestrit dhe të përfundojë pasi të realizohet programi me ngarkesën mësimore përkatëse të leksioneve, seminareve, laboratoreve apo formave të tjera të mësimdhënies.
- k) Në fillim të çdo viti akademik, mbështetur në planet mësimore të miratuara për vitin akademik për çdo program studimi, bazuar në burimet njerëzore të brendshme dhe të jashtme që ofron departamenti/fakulteti/universiteti dhe në varësi të kushteve të tjera, departamentet hartojnë planin mësimor të sugjeruar të vitit akademik, i cili miratohet nga Dekani i Fakultetit

l) Kohëzgjatja e orës së mësimit është 50 minuta.

Neni 4

Pranimi i studenteve në Programin e Ciklit të Dytë të studimeve "Master Profesional" në "Administrim Publik"

Pranimi i studentëve në Programin e Ciklit të Dytë të studimeve "Master Profesional" në "Administrim Publik", në Universitetin "Ismail Qemali" Vlore, realizohet bazuar në nenin 76 të Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në udhëzimet e përvitshme të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në vetë kriteret e parashikuara në nenin 39 të rregullores së UV si dhe në kriteret e propozuara nga njësitë bazë dhe të miratuara nga SA i Institucionit.

Neni 5

Ndërprerja e studimeve

Studenti mund të ndërpresë studimet në çdo kohë të vitit, për një afat jo më tepër se një vit dhe vetëm për këto raste:

- a) Kur sëmuret për periudha të gjata, të dokumentuara me raport nga komisioni mjekoligjor, ku të jenë shprehur qartë diagnoza e rekomandimi (jo nga mjeku i familjes).
- b) Kur mbetet kryefamiljar, në raste fatkeqësish e në kushte ekonomike të vështira, të dokumentuara nga zyrat përkatëse.

Në çdo rast dokumentat duhet të paraqiten përpara se të ndërpresë studimet, të shoqëruara me një kërkesë drejtuar Rektoratit. Studentët të cilët ndërpresin studimet për dy ose më shumë semestra radhë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

dhe nuk kanë marrë lejen nga rektori për këtë ndërprerje duhet të aplikojnë përsëri për pranim në universitet.

Neni 6

Transferimi i studimeve, njohja e krediteve dhe ekuivalentimi i lëndëve

Është e mundur njohja e plotë dhe e pjesshme e krediteve të studentëve që vijnë me transferim nga programe të tjera studimi brenda ose dhe jashtë universitetit. Pranë Departamentit ngrihet Komisioni i Njohjes dhe Ekuivalentimit i cili vlerëson dokumentacionin e studentit të përcjellë nga Sekretaria Mësimore dhe bën njohjen e krediteve përkatëse për disiplinat mësimore të likujduara për të cilën kërkohet njohja e krediteve. Modalitetet dhe procedurat për transferimin e studentëve janë të përcaktuara në Kreun VI të Rregullores së Brendshme të Universitetit.

KREU III

RREGULLAT E NDJEKJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE PROCEDURAT E DIPLOMIT

Neni 7

Frekuentimi dhe shlyerja e detyrimeve të lëndëve

- a. Frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm deri në masën 75%.
- b. Numri i mungesave të lejuara përlllogaritet për gjithë semestrin përkundrejt numrit total të orëve në semester.
- c. Çdo pedagog pajiset me regjistrin përkatës i cili përmban informacion mbi veprimtarinë e mësimdhënies dhe frekuentimit. Pedagogu përgjigjet drejtpërdrejt për saktësinë e informacionit mbi frekuentimin.
- d. Nëse studenti mungon gjatë zhvillimit të kursit dhe tejkalon numrin total të mungesave të lejuara për gjithë semestrin (jo më pak se 75 % frekuentim), atëherë studenti skualifikohet për shkak të mungesave, nuk futet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet mungesë (m) dhe përsërit kursin në semestrin e ardhshëm kur kursi ofrohet. Shënimi mungesë (m) do të pasqyrohet në procesverbalet përfundimtare nëse studenti ka plotësuar mungesat totale.
- e. Nëse studenti ka frekuentuar kursin por nuk paraqitet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet "Np - Nuk u paraqit". Nëse studenti nuk ka detyrime frekuentimi, por nuk është paraqitur në asnjë prej provimeve të pjesshme duke përfshirë dhe provimin final, në procesverbalin përfundimtar të vlerësimit do të bëhet shënimi "NP" (Nuk u paraqit), në të kundërt do të bëhet vlerësimi me notën përkatëse. Studentët nuk kanë detyrimin dhe nuk mund të regjistrohen në këto lëndë për të ndjekur kursin si përsëritës, por kanë të drejtën të shlyejnë lëndën vetëm me provim final, sipas përcaktimeve në këtë rregullore.
- f. Sekretaria mësimore e Departamentit të Biznesit përgjigjet për administrimin e informacionit mbi detyrimet akademike të studentëve në këtë program studimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Neni 8

Rregullat e zhvillimit të provimeve dhe vlerësimi i lëndës

Bazuar në nenet 60-65 të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

- a) Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet, me shkrim, me gojë ose i kombinuar me shkrim e me gojë, duke u mbështetur në programin mësimor.
- b) Kontrolli i dijeve në këtë program studimi të ciklit të dytë realizohet përgjatë semestrit nëpërmjet një provimi final gjithëpërfshirës si dhe formave të tjera të vlerësimit nëse janë parashikuar në syllabus-in e lëndës.
- c) Orari i provimeve finale duhet të shpallet para përfundimit të semestrit. Për semestrin e verës dhe sezonin e riprovimeve të dimrit kontrolli i dijeve realizohet vetëm nëpërmjet një provimi final.
- d) Rregulla apo specifika të provimeve, pesha (përqindja) e secilit provim apo detyre në vlerësimin përfundimtar, literatura, temat ose pjesët e programit të lëndës për çdo provim, dita apo java e provimit, ora dhe salla e zhvillimit, referencat e konvertimit të pikëve në notë etj., përcaktohen në syllabus-in e lëndës të hartuar nga pedagogu dhe u bëhet i ditur studentëve që ndjekin atë kurs.
- e) Pesha (përqindja) e formave të tjera të vlerësimit, të parashikuara në syllabus-in e lëndës, detyra kursi, projekte individuale, etj., janë jo më shumë se 10-15% e vlerësimit të përgjithshëm, të gjitha së bashku.
- f) Në rastin kur studenti nuk merr pjesë në një provim, por paraqet dokumentacion ku justifikon arsye të forta si probleme shëndetësore serioze (psh. shtrim në spital, aksident të rëndë), raste të jashtëzakonshme fatkeqësish familjare, apo raste urgjencash publike, vendimin për një mundësi tjetër për dhënien e provimit e merr Dekani i Fakultetit të Ekonomisë, duke u bazuar në kërkesën me shkrim të paraqitur nga studenti. Dekani ka të drejtë të kërkojë dokumentacion shtesë për të verifikuar mungesën.
- g) Kurset janë të gjitha semestrare. Nëse studenti nuk kualifikohet, pra ka shënim mungesë (m) në proceverbalin përfundimtar të kursit, ai ka të drejtën dhe detyrimin ta frekuentojë përsëri atë kurs, në semestrat pasardhës kur kursi ofrohet. Nëse kursi për arsye të ndryshme nuk do të ofrohet më (p.sh për arsye të ndryshimeve në kurrikula), studenti ka të drejtë të frekuentojë atë kurs që mund të ekuivalentohej me kursin që nuk ofrohet më, ose në rast të kundërt hapet kursi që nuk ofrohet më pavarësisht numrit të studentëve, vetëm për studentët që janë brenda afatit maksimal të studimeve të tyre, në zbatim të Vendimit të Senatit Akademik Nr. 10, dt. 07.02.2019. Krahas kurseve të përcaktuara në planet semestrare, studenti ka të drejtë të frekuentojë njëkohësisht edhe kurse të tjera për të cilat ka shënimin mungesë (m) nga semestri paraardhës, por duke respektuar rregullat e numrit të krediteve të regjistruara në një semestër dhe rregullat e përgjithshme të regjistrimit, sipas nenit 77 të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
- h) Tezat e provimit në të gjitha kontrollet hartohen nga titullari i lëndës. Kompromentimi i tezës është përgjegjësi direkte e pedagogut.
- i) Pas përfundimit të çdo provimi apo formave të tjera të kontrollit të dijeve, rezultatet editohen në sistemin elektronik të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, jo më larg se 48 orë nga data e zhvillimit të tij. Nëse pedagogu zhvillon provime të njëpasnjëshme për secilën prej tyre duhet të respektohet 48 orëshi për editimin e rezultateve në sistemin elektronik. Një ditë pas shpalljes së rezultateve, pranohen dhe vlerësohen ankesat e studentëve dhe në mbyllje të këtij procesi, printohet procesverbali nga sistemi, firmoset nga lektori dhe dorëzohet në sekretarinë mësimore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Në rast se pedagogu në mënyrë të pajustificuar, nuk ka edituar rezultatet e provimeve në sistem, konsiderohet shkelje akademike, për të cilën Drejtuesi i Departamentit dhe Dekani i Fakultetit marrin masat disiplinore.

- j) Në raste paqartësish, studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të lektorit të kursit, për të marrë sqarimet e duhura. Për sqarime të mëtejshme ata kanë të drejtë t'i drejtohen me shkrim Drejtuesit të Departamentit që mbulon kursin përkatës.
- k) Kur studenti në provim vlerësohet me notën 4 (katër) ose "NP" (Nuk u paraqit), ai ka të drejtën të regjistrohet për të shlyer këtë lëndë vetëm në semestrin e verës, sezonin e riprovimeve në dimër.
- l) Regjistrimi në këtë rast do të bëhet sipas rregullit të përgjithshëm të regjistrimit të përcaktuar në nenin 77 të rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
- m) Mesatarja e studentit llogaritet si mesatare e ponderuar. Shuma e produkteve të notave përfundimtare me kreditet përkatëse të lëndës pjostohet me totalin e kredive. (Bazuar në Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë neni 68, miratuar nga Senati Akademik me Vendim nr.57, datë 06.09.2018, i ndryshuar me vendim Nr 75, datë 19.11.2018, vendim Nr 5 datë 04.02.2019, vendim Nr 11, datë 27.02.2019.).

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, akordon për studentët në përfundim të studimeve titujt e nderit në tre nivele, në bazë të mesatares së përgjithshme të notave si më poshtë:

1. 8.00-8.89, cum laude
2. 8.90-9.39, magna cum laude
3. 9.40-10.00, summa cum laude

Këta tituj lëshohen së bashku me diplomën universitare të fituar nga studenti.

Neni 9


Sistemi i vlerësimit

Bazuar në Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë neni 68, miratuar nga Senati Akademik me Vendim nr.57, datë 06.09.2018, i ndryshuar me vendim Nr 75, datë 19.11.2018, vendim Nr 5 datë 04.02.2019, vendim Nr 11, datë 27.02.2019, Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, neni 60. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10. Nota më e ulët kaluese është nota 5 (pesë). Në procesverbalet evlerësimit përfundimtar për studentin jo kalues (ngelës) vendoset nota 4 (katër). Në të gjitha format e kontrollit të dijes përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht kthehet në notë.

Neni 10

Administrimi i dokumentacionit të provimeve

- a) Në fund të çdo provimi, testet dhe çdo material i provimit dorëzohet në sekretarinë e Departamentit të Biznesit, mbyllet në një zarf mbi të cilin të jenë shkruar të gjitha të dhënat e nevojshme dhe firmosen nga lektori.
- b) Zarfet me testet e provimeve të arkivuara në sekretarinë e departamentit, mund të hapen dhe të kontrollohen vetëm në rast ankimi ose shihet e arsyeshme nga autoritetet drejtuese. Këto materiale ruhen deri në fund të provimeve të semestrit pasardhës e më pas ato digjen.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- c) Ndalohet hyrja në provim e personave të jashtëm, me përjashtim të përgjegjësit të departamentit, autoriteteve drejtuese të fakultetit e personave të tjerë të autorizuar me shkrim nga Dekani ose Rektori për të kryer kontroll.
- d) Departamenti i Biznesit mund të propozojë ndërtimin e një Komisioni për mbikqyrjen e procesit të provimeve.

Neni 11

Ankimi për rezultatin përfundimtar

- a) Bazuar në nenin 62, të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim Drejtuesit të Departamentit brenda 48 orëve nga marrja në dijeni e rezultatit të provimit, i cili bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vëmenjëherë në dijeni Dekanin.
- b) Dekani, brenda 48 orësh nga marrja dijeni për ankesën nga Drejtuesi i Departamentit, ngre një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të Dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit.
- c) Ndryshimet në rezultatet e studentëve pasqyrohen në procesverbalin e ri të firmosur nga komisioni i cili i bashkëlidhet procesverbalit të mëparshëm dhe në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Univlora (SMI-Univlora).

Neni 12

Përmirësimi i notës

Bazuar në nenin 63, të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

- a) Studentët e ciklit të dytë kanë të drejtë të përmirësojnë notën në çdo lëndë, por jo më shumë se dy përmirësime në një vit akademik.
- b) Përmirësimet e notës bëhen vetëm në semestrin e verës, sezonin e riprovimeve të dimrit si dhe në datat e përcaktuara nga Dekani i Fakultetit para mbrojtjes së diplomës, kundrejt një tarife të miratuar. Është detyra e tij të regjistrohet në kurset që do të përmirësojë notën, pasi më parë ka bërë kërkesën në sekretarinë e departamentit, e cila e përcjell informacionin tek Drejtoria e IT-së për të mundur aksesin e studentit në regjistrimin e kursit. Kërkesa bëhet të pakten 10 ditë para fillimit të semestrit të verës, sezonit të riprovimeve të dimrit dhe mbrojtjes së diplomës.
- c) Studenti ka të drejtë të kërkojë përmirësimin e notës së një lënde jo më shumë se një herë.
- d) Studentët duhet të jenë në dijeni se mbetet në fuqi nota e përsëritjes së fundit, e cila do të pasqyrohet në transkriptin e notave që tregon ecurinë akademike të studentit, pavarësisht nëse kjo është nota më e lartë apo jo.
- e) Nëse nota e përsëritjes së fundit është 4 (katër) rregullat akademike për shlyerjen e detyrimeve nuk ndryshojnë.
- f) Në listën e notave që shoqërojnë diplomën do të pasqyrohen vetëm notat përfundimtare kaluese (5,6,7,8,9,10).

Neni 13

Praktika profesionale



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK


Bazuar në nenin 64, të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

- a) Studentët kanë të detyrueshme kryerjen e praktikës profesionale, kur ajo përfshihet në programin e studimit. Me fillimin e vitit akademik, departamenti u komunikon studentëve kohën e kryerjes, programin, mënyrën e zhvillimit dhe shlyerjes së saj.
- b) Praktikën profesionale zhvillohen në institucione sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga departamenti përkatës. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit ku kryen këtë proces.
- c) Gjatë kryerjes së praktikës profesionale, personeli akademik që drejton atë, ushtron kontroll të vazhdueshëm dhe mban lidhje me qendrën ku ajo kryhet. Në përfundim të praktikës profesionale, studentit përgatit një relacion për punën e kryer e cila vlerësohet nga pedagogu që e drejton praktikën pasi merr edhe mendimin e qendrës ku është kryer ajo. Vlerësimi bëhet me notë.
- d) Studentët të cilët i transferojnë studimet nga IAL-të tjera në Universitetin "Ismail Qemali" të Vlorës, por kanë lëndën e praktikës mësimore të vlerësuar Fitues/Jofitues dhe jo me notë, janë të detyruar që të zhvillojnë provimin e lëndës "Praktikë mësimore" por jo ta frekuentojnë atë

Neni 14
Diplomimi

Bazuar në nenin 65, të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

- a) Në përfundim të kursit të plotë të studimeve "Master Profesional" në "Administrim Publik", studentët kanë të drejtë të diplomohen. Kërkesat e diplomimit janë paraqitur në kurrikulën e programit të studimi "Master Profesional" në "Administrim Publik".
- b) Sekretaria mësimore e Departamentit të Biznesit është e detyruar t'i përcjellë me shkresë të veçantë Drejtuesit të Departamentit dhe Dekanit të Fakultetit listën e studentëve që kanë plotësuar detyrimet e programit të studimi dhe çdo detyrim tjetër financiar të cilët kanë të drejtën e mbrojtjes së tezës së diplomës. Sekretaria mësimore mban përgjegjësi për saktësinë e të dhënave.
- c) Drejtuesi i Departamentit pas marrjes së listës së studentëve ngre një komision ad-hoc, i cili verifikon nëse këta studentë kanë plotësuar detyrimet e programit të studimit. Pas verifikimit lista e studentëve që kanë të drejtën e mbrojtjes së tezës së diplomës, e firmosur nga anëtarët e komisionit, i përcillet përgjegjësit të departamentit.
- d) Në përfundim të programit të studimeve të ciklit të dytë, për fitimin e diplomës parashikohet një provim me gojë ose përgatitja e një teme diplome në varësi të notës mesatare të studentit deri në përfundim të semestrit të parafundit. Nota mesatare minimale që i jep të drejtën studentit që mbrojtjen e diplomës ta ketë me provim përfundimtar apo tezë diplome propozohet nga departamenti dhe miratohet nga Senati Akademik.
- e) Për fitimin e diplomave të ciklit të dytë të studimeve parashikohet përgatitja e një teze diplome, të përpunuar në mënyrë krijuese e të pavarur nga studenti.
- f) Drejtuesit e temave të diplomës miratohen nga drejtuesi i departamentit (referuar nenit 6 shkronja "g" të rregullores së programit).
- g) Mbrojtja e diplomës bëhet e hapur. Procedura e mbrojtjes përfshin një provim me gojë ose përgatitja e një teme diplome. Në përfundim juria bazuar në vlerësimin e udhëhëqësit dhe punimin e studentit, bën vlerësimin me notë. Juria dhe kryetari i saj miratohet nga Dekani i Fakultetit me



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

propozim të Drejtuesit të Departamentit dhe përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë. Shlyerja e detyrimeve të programit të studimit dhe çdo detyrimi tjetër financiar dhe material kundrejt universitetit, është kusht paraprak për kryerjen e mbrojtjes së tezës së diplomës.

- h) Drejtuesi i Departamentit i përcjellë Dekanit të Fakultetit listën e studentëve të diplomuar. Dekani nëpërmjet një shkrese ia përcjellë këtë listë Zyrës së Regjistrimit për të përgatitur diplomatat përkatëse.
- i) Në raste të veçanta kur studentët pengohen për t'u diplomuar vetëm për një lëndë të cilën e kanë frekuentuar dhe kanë vlerësimin me notën 4 (katër) ose shënimin "NP", Dekani i Fakultetit cakton data të posaçme për këto provime, përpara datës së përcaktuar për mbrojtjen e tezës së diplomës.
- j) Diplomimi në këtë program studimi të ciklit të dytë bëhet në fund të vitit akademik, datat dhe afatet përcaktohen nga Dekani i Fakultetit, duke mos krijuar pengesa në kohë për studentët që diplomohen.
- k) Kandidati që rrëzohet në mbrojtjen e diplomës, ka të drejtë të riparaqitet për mbrojtje në një datë të caktuar nga Dekani i Fakultetit në semestrin pasardhës.

Neni 15

Procedura e provimit të diplomës

- a) Bazuar në Vendimin e Senatit Akademik nr. 9, datë 26.01.2017, në shkresën nr. 532/1 Prot., datë 10.04.2017, të Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, provimi i diplomimit të studenteve të Ciklit të Dytë të Studimeve Master Profesional të cilët nuk plotësojnë kriterin e notës mesatare 8.5 (tetë e pesë të dhjetat), do të zhvillohet me gojë.
- b) Pyetjet për ciklin e dytë të studimeve Master Profesional "Administrim Publik" do të jenë nga lëndët me kodin BIZ, përveç atyre me zgjedhje, të planit mësimor përkatës.
- c) Pyetjet do të dorëzohen me firmë nga të gjithë pedagogët që zhvillojnë lëndën dhe do të protokollohen.
- d) Banka e të gjitha pyetjeve do t'u vihet në dispozicion studentëve të paktën 2 muaj para provimit të diplomimit, sipas mënyrës së parashikuar në Rregulloren e Univesitetit "Ismail Qemali" për dhënien e informacionit.
- e) Numri i pyetjeve në një tezë do të jetë tre.
- f) Tezat do të përgatiten ditën e provimit nga Komisioni i Provimit dhe do të firmosen nga Drejtuesi i Departamentit dhe nga Dekani.
- g) Studenti ka të drejtë ta ndërrojë tezën deri në dy herë dhe për çdo ndërrim teze do t'i ulen dy nota.
- h) Studentit do t'i jepet mundësia të përgatitet për tezën përkatëse për 20 minuta, dhe pas këtij afati të lënë në dispozicion të tij, studenti do të përgjigjet me gojë për pyetjet që përmban teza.
- i) Komisioni i Provimit të Diplomës përbëhet nga 5 anëtarë.
- j) Çdo anëtar i komisionit jep vlerësimin përkatës për çdo student, dhe vlerësimi final i studentit do të jetë mesatarja e thjeshtë aritmetike e vlerësimeve të 5 anëtarëve të Komisionit të Provimit të Diplomës.
- k) Të gjitha procedurat e tjera të diplomimit do të zhvillohen sipas rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe rregullores së Departamentit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

**Neni 16
Pajisja me diplome**

Bazuar në nenin 66, të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

- Studentët që kanë plotësuar detyrimet e programit të studimit dhe çdo detyrim tjetër financiar dhe material kundrejt universitetit pajisen me diplomë e cila është një dokument zyrtar.
- Diplomat e Programit të Ciklit të Dytë të studimeve "Master Profesional" në "Administrim Publik" shoqërohet me listën e Notave (në listën e notave që shoqërojnë diplomën pasqyrohen vetëm notat përfundimtare kaluese ≥ 5 të çdo lënde) dhe me suplementin e diplomës. Suplementi i Diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e hapësirës europiane të arsimit të lartë. Ai përshkruan në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve që janë kryer dhe përfunduar me sukses nga mbajtësi i diplomës.
- Përmbajtja dhe forma e diplomës është e përcaktuar në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Diploma nënshkruhet prej Dekanit të Fakultetit Ekonomik dhe Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Për secilin prej tyre shënohet emri, mbiemri, grada dhe titulli shkencor. Nënshkrimi i Rektorit shoqërohet me vulën e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
- Për këtë program të ciklit të dytë të studimeve lëshohet diploma: Diplomë "Master Profesional" në "Administrim Publik".

**Neni 17
Tërheqja e diplomës**

Bazuar në nenin 67, të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

- Tërheqja e diplomës bëhet personalisht nga i diplomuari, kundrejt nënshkrimit dhe evidentohet në regjistrin përkatës.
- Nëse prania e të diplomuarit është objektivist e pamundur, tërheqjen e diplomës mund t'a bëjë një nga pjesëtarët e familjes, i pajisur me prokurë të posaçme e cila bashkëngjitet në regjistrin e tërheqjes së diplomave, duke paraqitur dhe një dokument identifikimi të tij.
- Nëse diploma nuk është plotësuar në rregull, i interesuari duhet të mos e tërheq atë dhe të kërkojë pajisjen me diplomë të rregullt. Nëse i interesuari e tërheq diplomën e parregullt, në rast se i humbet origjinali ose i dëmtohet duke iu bërë i papërdorshëm, universiteti nuk lëshon dublikatë. Lejohet vetëm dhënia e listës së notave të fituara dhe vërtetim me fotografi i cili është ekuivalent me diplomën, pasi nënshkruhet nga rektori i universitetit, Dekani dhe përgjegjësi i zyrës së regjistrimit. Nënshkrimet e tyre vërtetohen me vulën e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Diploma e plotësuar në mënyrë të parregullt, asgjësohet me një komision të përbërë prej tre anëtarësh të caktuar me urdhër të dekanit me hartimin e procesverbalit përkatës, i cili depozitohet në zyrën e regjistrimit, përpara se i interesuari të pajiset me vërtetim me fotografi ekuivalent me diplomën.
- Nëse një shtetas i diplomuar në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë rezulton me dy dokumente diplomimi, diplomë origjinale dhe vërtetim me fotografi ekuivalent me diplomën, do të quhet i vlefshëm dokumenti i lëshuar në datën më të vonë.
- Në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni të përgjithshme për të gjithë fakultetet në shkallë universiteti dhe dorëzimi i diplomave bëhet personalisht nga



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Rektori, në prani të përfaqësuesve të Senatit Akademik, të profesoratit, administratës dhe studentëve.

**KREU IV
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E STUDENTËVE**


**Neni 18
Të drejtat e studentëve**

Të drejtat dhe obligimet e studentëve janë të parashikuara në nenin 70 të Rregullores së UV, 2014, ndërsa shkeljet disiplinore nga studentët parashikohen në nenin 74 të po kësaj rregulloreje.

Studenti ka të drejtë:

- a. Të ndjekë leksione, seminare dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore, të organizuara në përputhje me statusin e tij.
- b. Të përdorë pajisjet, bazën materiale dhe laboratorike të universitetit sipas rregullave përkatëse, për të realizuar programin mësimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tij shkencor, bibliotekën dhe mjediset sportive e kulturore të universitetit.
- c. Të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet drejtuese, si në Senatin Akademik, në Bordin e Administrimit, ku janë të regjistruar, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe Statutin e Universitetit.
- d. Të organizohet në shoqata të ndryshme jopolitike në përputhje me aktet ligjore e nënligjore përkatëse.
- e. Të përfitojë bursë studimi brenda ose jashtë shtetit kur plotëson kushtet e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, Senatit e në marrëveshjet ndërshtetërore ose ndëruniversitare.
- f. Të përfitojë shpërblime të veçanta që akordohen nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë sipas ligjit dhe kriterëve të caktuar nga Senati Akademik.
- g. Të shprehë opinionin e tij për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të universitetit
- h. Të ankohet për shkelje të rregullave dhe standarteve akademike nga ana e pedagogëve, mosrealizim të procesit të mësimdhënies, rregullat për zhvillimin e provimit dhe për vlerësimin e tij të pamerituar.
- i. Të ankohet për shkelje të etikës akademike, të konfliktit të interesit dhe të çdo rasti tjetër që çënon integritetin e studentit.
- j. Të ndjekë studimet në një degë të dytë, në sistem të ndryshëm nga ai që ndjek, sipas përcaktimeve në këtë rregullore, në vendimet e Senatit apo në aktet e posaçme të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit.

Të drejta të tjera të studenteve janë përcaktuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në Statutin (2019) dhe në Rregulloren (2014) të UV.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Neni 19

Detyrimet e studentëve

Studenti është i detyruar:

- Të njohë me hollësi Statutin, Rregulloren e Universitetit dhe çdo Rregullore tjetër e detyrimet që lindin për të dhe të jetë i vetëdijshëm për zbatimin e tyre, në të kundërt, universiteti nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre.
- Të njohin të gjitha kërkesat e përgjithshme të universitetit, si dhe kërkesat specifike të programit në fushën që ata kanë zgjedhur. Studentët janë përgjegjës për t'iu përgjigjur të gjitha kërkesave dhe rregulloreve përkatëse në bazë të diplomave që ata synojnë.
- Të zbatojë të gjitha rregullat që rrjedhin nga Statuti i Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës, nga kjo rregullore dhe nga çdo akt tjetër ligjor e nënligjor për arsimin e lartë.
- Të respektojë Kodin e Etikes së univeristetit.
- Të shlyejë detyrimet e përcaktuara në programin e studimit si dhe çdo detyrim tjetër financiar dhe material ndaj universitetit.
- Të shlyejë të gjitha detyrimet financiare të parashikuara në ligj.
- Të mbajë përgjegjësi për shkeljet e rregullave të universitetit nga ana e tij; dëmet materiale që ai mund të ketë bërë zhdëmtohen në masën e përlogaritur.

Detyra apo përgjegjësi të tjera të studentëve janë përcaktuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në Statutin (2019) dhe në Rregulloren (2014) e UV-së.

Neni 20

Përgjegjësi të tjera të studentëve


Përgjegjësitë e studentit përfshijnë ndër të tjera edhe pikat më poshtë:

- Studenti duhet të njohë dhe të respektojë rregullat e zhvillimit të orës së mësimi të përcaktuara në syllabus dhe të komunikuar në auditor nga pedagogu.
- Studenti duhet t'i drejtojë ankesat akademike në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor tek autoritetet drejtuese.
- Studenti duhet të respektojë oraret e konsultimeve të komunikuar nga pedagogu.

Neni 21

Masat disiplinore per studentet

Shkelje e rregullave të universitetit konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që cënojnë personalitetin e personelit akademik, të çdo punonjësi tjetër të universitetit dhe çdo student, normat etiko-morale të shoqërisë si kopjimi në provime, falsifikimi i dokumentave të ndryshme, fyerjet, sharjet, aktet e rrugaçërisë, të vjedhjes etj., kur këto veprime nuk bartin elementë të veprës penale. Ndaj studentit që kryen këto veprime, merren këto masa disiplinore:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- a) Vërejtje me shkrim;
- b) Paralajmërim për pezullim ose përjashtim nga universiteti;
- c) Pezullimin nga universiteti për një semester ose një vit;
- d) Përjashtim nga universiteti "Ismail Qemali" Vlorë;
- e) Përjashtim përgjithmonë nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë.

Vendimin për "Vërejtje me shkrim", "Paralajmërim për pezullim ose përjashtim nga universiteti" dhe "Pezullim nga universiteti për një semester ose një vit" e merr dekanati përkatës. Në raste të veçanta të parashikuara në Kodin e Etikës këto vendime mund të merren nga Rektorati.

Vendimin për "Përjashtimin nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë" (heqje vetëm e së drejtës së studimit të filluar) dhe "Përjashtimin përgjithmonë nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë (duke mos i lejuar të fitojë të drejta studimi të mëpasshme) e merr Rektorati i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, mbi bazën e propozimit të dekanatit.

Studenti konsiderohet i rehabilituar, nëse nuk bën shkelje tjetër me kalimin e tre muajve për vërejtjen, brenda gjashtë muajve për paralajmërimin dhe një viti për pezullimin.

KREU V
KOMUNIKIMI

Neni 22

Rregullat e sjelljes akademike

Të gjithë anëtarët e komunitetit akademik në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë duhet të praktikojnë dhe të ruajnë standartet e integritetit akademik dhe ndershmërisë. Integritet akademik do të thotë të paraqesësh vetveten dhe punën tënde me ndershmëri. Më poshtë janë disa shembuj pandershmërie akademike:

- a. Mashtrim në provime. Këtu përfshihet: përdorimi i materialeve si libra dhe/ose shënime në formë të printuar apo elektronike kur një gjë e tillë nuk është e autorizuar nga pedagogu, kopjimi nga testimi apo detyra e dikujt tjetër, lejimi i dikujt tjetër për të kopjuar punën tënde, zëvendësimi i punës tënde me punën e dikujt tjetër, ose të tjera forma shkeljesh në sjellje gjatë provimeve.
- b. Plagjiaturë e punës së të tjerëve. Plagjiaturë do të thotë të përdorësh punën ose idetë e dikujt tjetër duke i konsideruar ato të veta.
- c. Falsifikimi i dokumentave apo paraqitja dizinformuese e kredencialeve të një personi është shkelje.

Pedagogët duhet të respektojnë standartet e mëposhtme në kontekstin e sjelljes akademike:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- a. Të informojnë dhe të udhëzojnë studentët mbi procedurat dhe standartet e punës kërkimore, si dhe mbi dokumentacionin e kërkuar për të kryer detyra në një kurs të caktuar apo në kontekstin e një disipline të caktuar.
- b. Të ndërmarrin hapa konkretë për të dalluar dhe parandaluar mashtrimin.
- c. Të raportojnë sjelljen akademike të dyshuar jo etike tek dekani.
- d. Të paraqesin evidencë të plagjiaturës, të mashtrimit në provime apo raporte laboratorit, të fallsifikimeve të dokumentave apo të tjera forma sjelljeje të pandershme akademike në autoritetet drejtuese përkatëse.

Studentët duhet të respektojnë standardet e mëposhtme në kontekstin e sjelljes akademike:


- a. Të jenë në dijeni të praktikave dhe standardeve të shkollimit të ndershëm.
- b. Të ndjekin udhëzimet e pedagogëve në lidhje me provimet dhe detyrat në mënyrë që të evitojnë një paraqitje të keqe të punës.
- c. Të jenë të sigurt që rregulla të veçanta në lidhje me dokumentimin e detyrave të kursit, të procedurave të provimit, të përdorimit të informacioneve e programeve kompjuterike, etj., janë kuptuar qartë.
- d. Të evitojnë aparencën e mashtrimit (të lënit përshtypje sikur po mashtrojnë). Nëse studentët janë të bindur që praktikat e përdorura nga pedagogu janë të favorshme ndaj mashtrimit, ata mund t'ia përcjellin këtë mesazh Drejtuesit të Departamentit, Dekanit ose t'i drejtohen me ankesë të drejtëpërdrejtë Rektorit. Raste të tilla do të gjykohen dhe vlerësohen sipas rregulloreve në fuqi.

Neni 23

Normat etike gjatë komunikimit Personel Akademik – Student

Gjatë veprimtarisë së mësimdhënies shpesh vihen re problematika rreth koordinimit të punës së stafit me studentët. Për këtë qëllim kjo Rregullore sugjeron të ndiqen disa udhëzime praktike të miratuara si më poshtë:

- a) Studenti është i detyruar të zbatojë e respektojë Kodin e Etikës të miratuar në UV.
- b) Kontakti i pedagogut me studentin për aspekte të mësimdhënies apo kërkimit shkencor do të bëhet vetëm në ambientet e auditoreve, laboratoreve dhe në asnjë rast jashtë tij.
- c) Komunikimi me studentin mund të bëhet në rrugë elektronike në adresën e pedagogut e cila është regjistruar më parë në departament.
- d) Justifikimet nga ana e studentëve tek pedagogu për mungesat gjatë vitit pranohen vetëm pas dorëzimit të raporteve të marrë nga komisione të posacëm.
- e) Në rast të vonesave të pedagogut në auditor studentit duhet të presë disa minuta dhe nëse pedagogu nuk ka njoftuar paraprakisht ai mund të largohet.
- f) Në auditor, laboratorë si dhe gjatë provimit nuk lejohet përdorimi i mjeteve të komunikimit.
- g) Në ditën e provimit studentit respekton me përpikmëri datën, vendin e provimit, si dhe siguron mjetet e nevojshme (stilolaps, makinë llogaritëse, mjet identifikimi).
- h) Në ambjentet e provimit nuk lejohet prania e familjarëve të studentit përveçse personave të autorizuar nga ana e Drejtuesit të Departamentit (pedagogë, sekretare).
- i) Pedagogu ju'a komunikon notën studentëve duke respektuar konfidencialitetin (në mungesë të sistemit) ose bën verifikime të vlerësimit në një orar e sallë të caktuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK**

Për komunikime të pedagogut me studentët që kanë tema diplome hartohet një grafik i konsultimit në një sallë e ditë të caktuar javore.

Neni 24

Çështje akademike

Çdo njësi akademike duhet të respektojë procedurat për zgjidhjen e ankesave, në lidhje me vlerësimin, standartin dhe cilësinë e mësimdhënies, situatat brenda në klasë dhe çdo problem tjetër akademik. Për rastet e ankesave në lidhje me vlerësimin, ndiqet ajo procedurë e përcaktuar në nenin 62 të rregullores së UV.

Neni 25

Çështje jo akademike


Personeli i universitetit dhe studentët mund të hasin situata problematike gjatë kohës së punës apo të studimeve në universitetin "Ismail Qemali" Vlorë në të cilat mund të perfshihen rastet e fyerjeve, sharjeve, konfrontimeve fizike. Qëndrimi diskriminues apo ngacmimi seksual, sharjet apo fyerjet raciale, sharjet për orientimin seksual, për ngjyrën, fenë, bindjet, origjinën kombëtare apo prejardhjen, gjendjen martesore, gjendjen familjare etj., kërkojnë vëmendje të veçantë në zgjidhjen e tyre.

KREU VI

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 26

Çdo çështje që lind nga zbatimi i kësaj rregulloreje dhe nuk mbulohet prej saj, rregullohet me Rregulloren e Brendshme të Universitetit. Në rast se edhe kjo e fundit nuk e mbulon, atëherë Departamenti i propozon Rektorit dhe Senatit Akademik propozimin përkatës për miratim. Asambleja e Departamentit të Biznesit ka të drejtën dhe detyrimin e rishikimit periodik të kësaj rregulloreje, dhe përcjelljen për miratim në Senatin Akademik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

RREGULLORE E PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT
“MASTER PROFESIONAL” në “MARKETING”

Departamenti i Biznesit

Dhjetor 2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK**

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Baza ligjore**

Kjo rregullore bazohet në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimin e MASR, për çeljen e Programeve të Studimit, Statutit (2019) dhe Rregullores (2014) të Universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës.

**Neni 2
Misioni dhe objektivat**

- a) Rregullorja synon të krijojë një kuadër të plotë dhe të qartë për programin e ciklit të dytë të studimit “Master Profesional” në “Marketing”, si dhe të përcaktoj rregulla standarte të përgatitjes, organizimit dhe administrimit të studentëve të këtij cikli.
- b) Kjo rregullore i bashkangjitet Rregullores së Brendshme të Departamentit të Biznesit dhe shtrin efektin e saj mbi njësinë mësimore – shkencore përgjegjëse për organizimin e Programit të Ciklit të dytë “Master Profesional” në “Marketing”.
- c) Ky program studimi përfshihet në ciklin e dytë të studimeve universitare të ofruara prej Departamentit të Biznesit, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë dhe siguron Diplomë Universitare “Master Profesional” në “Marketing”.

**KREU II
ORGANIZMI I PROGRAMIT TE STUDIMIT**

**Neni 3
Programi i studimit**

Programi i studimit “Master Profesional” në “Marketing” siguron Diplomë Universitare “Master Profesional” në “Marketing”. Ky program organizohet dhe shprehet përmes grumbullimit të krediteve sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS). Për të fituar këtë diplomë nevojiten 60 kredite (ECTS). 60 kredite (ECTS) përfaqësojnë ngarkesën e punës së një viti akademik studimesh, aq sa është edhe kohëzgjatja e këtij programi studimesh.

- a) Viti akademik është njësia kohore bazë e studimeve. Një vit akademik përbëhet nga 2 semestra dhe shtrihet në intervalin nga 30 deri 40 javë mësimore, sipas udhëzimeve MASR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- (30 javë mësim dhe 6-8 javë provime dhe provim formimi / mbrojtje teze diplome). Fillimi dhe përfundimi i vitit akademik përcaktohet me Udhezim të MASR në çdo fillim viti akademik.
- b) Çdo semestër zgjat 15 javë për mësim dhe mesatarisht 3-4 javë për provime. Organizimi i vitit akademik, datat e fillimit të semestrave dhe sezoni i provimeve, shpallen nga rektori në fillim të viti akademik.
 - c) Në fillim të çdo viti akademik, mbështetur në kurrikulat e programeve të studimit, departamentet përcjellin planin mësimor për miratim tek Dekani i Fakultetit dhe Rektori. Për çdo kurs hartohen programet mësimore (syllabus).
 - d) Me fillimin e vitit akademik, Departamenti shpall orarin mësimor: ditën, orën, sallën dhe personelin akademik përkatës, për semestrin përkatës.
 - e) Moduli themelor i studimit është lënda semestrale me kredite (ECTS) të bashkangjitura në planin mësimor të miratuar të programit të studimit.
 - f) Numri i caktuar i kredive fitohet pas përfundimit me sukses të disiplinës, siç është përshkruar në këtë Rregullore dhe në Rregulloren e Brendshme të Universitetit.
 - g) Vlerësimi i studentëve bëhet nga personeli akademik përkatës që zhvillon disiplinat mësimore, i cili organizon sipas gjykimit të tij kontrole me gojë, me shkrim, ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë, detyra të pavarura, detyra kursi etj., në përputhje me mënyrat e vlerësimit të përcaktuara në këtë Rregullore dhe në Rregulloren e Brendshme të Universitetit.
 - h) Studenti përfundon studimet në këtë program studimi dhe merr diplomë kur ka likujtuar me sukses gjithë disiplinat mësimore të parashikuara në planin mësimor përkatës, ka mbrojtur me sukses tezën e diplomës / provimin e formimit, kjo në varësi të notës mesatare që arrin studenti gjatë të dy semestrave të studimit, dhe ka fituar 60 kredite (ECTS). Këto dy forma vlerësimi përmbajnë tematika të lëndëve të drejtimit që ka ndjekur në program, me qëllim krijimin dhe vlerësimin e dijeve të fituara në disiplina të ndryshme.

vi. Tematika e temës së diplomës

Tema e diplomës mund të jetë bibliografike, kërkimore apo dhe kombinim i të dyjave për çështje që lidhen me disiplinat mësimore të planit mësimor të programit të studimit.

Miratimi i udhëheqësit të diplomës dhe fushës së studimit bëhet në departament me propozim të udhëheqësit pasi ky i fundit ka diskutuar dhe dakortësuar me studentin.

Zgjedhja e temës së diplomës duhet të bëhet nga studentin dhe të jetë aprovuar nga udhëheqësi i tij/saj shkencor.

Realizimi me sukses i punimit kërkon angazhim maksimal të studentit, i cili duhet të zhvillojë kontakte të vazhdueshme dhe të raportojë në mënyrë sistematike tek udhëheqësi punën e kryer sipas një skeduli të përcaktuar paraprakisht.

Tema e diplomës duhet të përfaqësojë një punë kërkimore shkencore origjinale dhe të mos jetë paraqitur në ndonjë institucion tjetër arsimor.

Studenti duhet të përcaktojë qartë metodologjinë kërkimore (induktive apo deduktive) të studimit në varësi të kontekstit të studimit.

Struktura e temës duhet të jetë e qartë dhe duhet të zbatohet pavarësisht tipit të metodologjisë së përzgjedhur në të.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Përmbajtja e temës së diplomës duhet të paraqesi një vështrim të literaturës së huaj dhe të asaj vendase, e cila tregon se studenti e njeh mirë fushën e tij kërkimore dhe është në gjendje të paraqesi koncepte teorike, të analizojë dhe të krahasojë zhvillimin e modeleve teorike nga autorë të huaj apo vendas.

Gjithashtu, vështrimi i literaturës duhet të përmbajë paraqitje dhe krahasime të rezultateve të punimeve empirike të autorëve të huaj dhe vendas të kohëve më të fundit dhe të pasqyrojë hendekun që ekziston në literaturë nën kontestin e vendit tonë.

Një pasqyrë e përgjithshme e variablave të marrë në studim duhet të bëhet për Shqipërinë për të evidentuar dhe kuptuar më mirë ecurinë e variablave në kohë dhe evidentimin e problematikave të tyre (nëse ka).

Zgjedhja e tipit të të dhënave dhe aplikimi i metodave të duhura kërkimore është një mundësi për të dëshmuar pjekurinë e tij/saj akademike dhe aftësinë për të aplikuar punë kërkimore në të ardhme.

Mbyllja e punimit kërkimor shkencor realizohet me nxjerrjen e konkluzioneve dhe dhënien e sugjerimeve për grupet e ndryshme të interesit.

Shkrimi i temës së diplomës i mundëson studentit të mësojë gjëra të reja për veten e tij/saj, për shembull, për kapacitetin, perceptimin, kreativitetin, këmbënguljen dhe mënyrën e të punuarit.

vii. Forma dhe volumi i tezës së diplomës

Punimi i diplomës për ciklin e dytë të studimit Master Profesional duhet të ketë një numër faqesh minimalisht prej 50 faqe. Kriteret e punimit të temës së diplomës dhe formati i saj duhet të jetë konform Vendimit të Këshillit të Fakultetit me Nr 190 Prot datë 02.07.2014.

viii. Diagrama kohore

Studentit që i lind e drejta për tu diplomuar me temë diplome, në fillim të semestrit përkatës, por jo më vonë se java e dytë, aplikon në sekretari për temë diplome duke plotësuar një formular ku propozon udhëheqësin e temës së diplomës. Ky i fundit miratohet nga drejtuesi i departamentit jo më vonë se java e katërt. Udhëheqësi i diplomës dorëzon një deklaratë ku të dy palët (udhëheqësi dhe studenti) kanë rënë dakort për të punuar së bashku mbi fushën e studimit të përzgjedhur, jo më vonë se java e tretë e semestrit. Afati i dorëzimit të punimit të temës së diplomës është një javë para datës së provimit të diplomës.

ix. Detyrime të pedagogut udhëheqës

- Të dorëzojë në kohë propozimet për studentët që merr përsipër të udhëheqë, si dhe fushën e studimit..
- Orientime dhe takime këshilluese në periudha të rregullta kohore me studentët. T'u ofrojë studentëve udhëzime për shkrimin dhe mbrojtjen e temës si dhe për vlerësimin e saj.

x. Vlerësimi

- Tema e diplomës vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash përpara një komisioni të ngritur në Departament.

i) Kohëzgjatja maksimale e studimeve nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimit që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën kur student i ka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

pezulluar studimet. Studenti mund të përfundojë studimet e plota dhe të mbrojë diplomën, brenda afatit të rregullt të studimeve ose tej kufirit që parashikon ky afat, por duke iu nënshtruar detyrimeve që lindin nga kohëzgjatja e studimeve përtej kohës normale.

j) Bazuar në Nenin 45 "Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies" të Rregullores së Universitetit, në ciklin e dytë të studimeve master, semestret e vjeshtës dhe pranverës kanë të njëjtën kohëzgjatje, por me specifikën që programi i një disipline mund të realizohet jo domosdoshmërisht për një periudhë 15-javore, bazuar në burimet njerëzore të brendshme dhe të jashtme që ofron universiteti dhe në varësi të kushteve të tjera. Kjo nënkupton që plani mësimor semestral mund realizohet, duke bërë një organizim të mësimdhënies dhe shpërndarje të disiplinave përgjatë tij, që do të thotë se mësimdhënia në një disiplinë mund të fillojë në një nga javët e semestrit dhe të përfundojë pasi të realizohet programi me ngarkesën mësimore përkatëse të leksioneve, seminareve, laboratoreve apo formave të tjera të mësimdhënies.

k) Në fillim të çdo viti akademik, mbështetur në planet mësimore të miratuara për vitin akademik për çdo program studimi, bazuar në burimet njerëzore të brendshme dhe të jashtme që ofron departamenti/fakulteti/universiteti dhe në varësi të kushteve të tjera, departamentet hartojnë planin mësimor të sugjeruar të vitit akademik, i cili miratohet nga Dekani i Fakultetit

l) Kohëzgjatja e orës së mësimit është 50 minuta.

Neni 4

**Pranimi i studenteve në Programin e Ciklit të Dytë të studimeve "Master Profesional" në
"Marketing"**

Pranimi i studentëve në Programin e Ciklit të Dytë të studimeve "Master Profesional" në "Marketing", në Universitetin "Ismail Qemali" Vlore, realizohet bazuar në nenin 76 të Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në udhëzimet e përvitshme të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në vetë kriteret e parashikuara në nenin 39 të rregullores së UV si dhe në kriteret e propozuara nga njësitë bazë dhe të miratuara nga SA i Institucionit.


Neni 5

Ndërprerja e studimeve

Studenti mund të ndërpresë studimet në çdo kohë të vitit, për një afat jo më tepër se një vit dhe vetëm për këto raste:

- a) Kur sëmuret për periudha të gjata, të dokumentuara me raport nga komisioni mjekoligjor, ku të jenë shprehur qartë diagnoza e rekomandimi (jo nga mjeku i familjes).
- b) Kur mbetet kryefamiljar, në raste fatkeqësish e në kushte ekonomike të vështira, të dokumentuara nga zyrat përkatëse.

Në çdo rast dokumentat duhet të paraqiten përpara se të ndërpresë studimet, të shoqëruara me një kërkesë drejtuar Rektoratit. Studentët të cilët ndërpresin studimet për dy ose më shumë semestra radhë dhe nuk kanë marrë lejen nga rektori për këtë ndërprerje duhet të aplikojnë përsëri për pranim në universitet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Neni 6

Transferimi i studimeve, njohja e krediteve dhe ekuivalentimi i lëndëve

Është e mundur njohja e plotë dhe e pjesshme e krediteve të studentëve që vijnë me transferim nga programe të tjera studimi brenda ose dhe jashtë universitetit. Pranë Departamentit ngrihet Komisioni i Njohjes dhe Ekuivalentimit i cili vlerëson dokumentacionin e studentit të përcjellë nga Sekretaria Mësimore dhe bën njohjen e krediteve përkatëse për disiplinat mësimore të likujduara për të cilën kërkohet njohja e krediteve. Modalitetet dhe procedurat për transferimin e studentëve janë të përcaktuara në Kreun VI të Rregullores së Brendshme të Universitetit.

KREU III

RREGULLAT E NDJEKJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE PROCEDURAT E DIPLOMIT

Neni 7

Frekuentimi dhe shlyerja e detyrimeve të lëndëve

- Frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm deri në masën 75%.
- Numri i mungesave të lejuara përlllogaritët për gjithë semestrin përkundrejt numrit total të orëve në semester.
- Çdo pedagog pajiset me regjistrin përkatës i cili përmban informacion mbi veprimtarinë e mësimdhënies dhe frekuentimit. Pedagogu përgjigjet drejtpërdrejt për saktësinë e informacionit mbi frekuentimin.
- Nëse studenti mungon gjatë zhvillimit të kursit dhe tejkalon numrin total të mungesave të lejuara për gjithë semestrin (jo më pak se 75 % frekuentim), atëherë studenti skualifikohet për shkak të mungesave, nuk futet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet mungesë (m) dhe përsërit kursin në semestrin e ardhshëm kur kursi ofrohet. Shënimi mungesë (m) do të pasqyrohet në procesverbalet përfundimtare nëse studenti ka plotësuar mungesat totale.
- Nëse studenti ka frekuentuar kursin por nuk paraqitet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet "Np - Nuk u paraqit". Nëse studenti nuk ka detyrime frekuentimi, por nuk është paraqitur në asnjë prej provimeve të pjesshme duke përfshirë dhe provimin final, në procesverbalin përfundimtar të vlerësimit do të bëhet shënimi "NP" (Nuk u paraqit), në të kundërt do të bëhet vlerësimi me notën përkatëse. Studentët nuk kane detyrimin dhe nuk mund të regjistrohen në këto lëndë për të ndjekur kursin si përsëritës, por kanë të drejtën të shlyejnë lëndën vetëm me provim final, sipas përcaktimeve në këtë rregullore.
- Sekretaria mësimore e Departamentit të Biznesit përgjigjet për administrimin e informacionit mbi detyrimet akademike të studentëve në këtë program studimi.

Neni 8

Rregullat e zhvillimit të provimeve dhe vlerësimi i lëndës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Bazuar në nenet 60-65 të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

- a) Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet, me shkrim, me gojë ose i kombinuar me shkrim e me gojë, duke u mbështetur në programin mësimor.
- b) Kontrolli i dijeve në këtë program studimi të ciklit të dytë realizohet përgjatë semestrit nëpërmjet një provimi final gjithëpërfshirës si dhe formave të tjera të vlerësimit nëse janë parashikuar në syllabus-in e lëndës.
- c) Orari i provimeve finale duhet të shpallet para përfundimit të semestrit. Për semestrin e verës dhe sezonin e riprovimeve të dimrit kontrolli i dijeve realizohet vetëm nëpërmjet një provimi final.
- d) Rregulla apo specifika të provimeve, pesha (përqindja) e secilit provim apo detyre në vlerësimin përfundimtar, literatura, temat ose pjesët e programit të lëndës për çdo provim, dita apo java e provimit, ora dhe salla e zhvillimit, referencat e konvertimit të pikëve në notë etj., përcaktohen në syllabus-in e lëndës të hartuar nga pedagogu dhe u bëhet i ditur studentëve që ndjekin atë kurs.
- e) Pesha (përqindja) e formave të tjera të vlerësimit, të parashikuara në syllabus-in e lëndës, detyra kurse, projekte individuale, etj., janë jo më shumë se 10-15% e vlerësimit të përgjithshëm, të gjitha së bashku.
- f) Në rastin kur studenti nuk merr pjesë në një provim, por paraqet dokumentacion ku justifikon arsye të forta si probleme shëndetësore serioze (psh. shtrim në spital, aksident të rëndë), raste të jashtëzakonshme fatkeqësish familjare, apo raste urgjencash publike, vendimin për një mundësi tjetër për dhënien e provimit e merr Dekani i Fakultetit të Ekonomisë, duke u bazuar në kërkesën me shkrim të paraqitur nga studenti. Dekani ka të drejtë të kërkojë dokumentacion shtesë për të verifikuar mungesën.
- g) Kurset janë të gjitha semestrale. Nëse studenti nuk kualifikohet, pra ka shënim mungesë (m) në proceverbalin përfundimtar të kursit, ai ka të drejtën dhe detyrimin ta frekuentojë përsëri atë kurs, në semestrat pasardhës kur kursi ofrohet. Nëse kursi për arsye të ndryshme nuk do të ofrohet më (p.sh për arsye të ndryshmeve në kurrikula), studenti ka të drejtë të frekuentojë atë kurs që mund të ekuivalentohej me kursin që nuk ofrohet më, ose në rast të kundërt hapet kursi që nuk ofrohet më pavarësisht numrit të studentëve, vetëm për studentët që janë brenda afatit maksimal të studimeve të tyre, në zbatim të Vendimit të Senatit Akademik Nr. 10, dt. 07.02.2019.. Krahës kurseve të përcaktuara në planet semestrale, studenti ka të drejtë të frekuentojë njëkohësisht edhe kurse të tjera për të cilat ka shënimin mungesë (m) nga semestri paraardhës, por duke respektuar rregullat e numrit të krediteve të regjistruara në një semestër dhe rregullat e përgjithshme të regjistrimit, sipas nenit 77 të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
- h) Tezat e provimit në të gjitha kontrollet hartohen nga titullari i lëndës. Kompromentimi i tezës është përgjegjësi direkte e pedagogut.
- i) Pas përfundimit të çdo provimi apo formave të tjera të kontrollit të dijeve, rezultatet editohen në sistemin elektronik të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, jo më larg se 48 orë nga data e zhvillimit të tij. Nëse pedagogu zhvillon provime të njëpasnjëshme për secilën prej tyre duhet të respektohet 48 orëshi për editimin e rezultateve në sistemin



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË SENATI AKADEMIK

elektronik. Një ditë pas shpalljes së rezultateve, pranohen dhe vlerësohen ankesat e studentëve dhe në mbyllje të këtij procesi, printohet procesverbali nga sistemi, firmoset nga lektori dhe dorëzohet në sekretarinë mësimore. Në rast se pedagogu në mënyrë të pajustificuar, nuk ka edituar rezultatet e provimeve në sistem, konsiderohet shkelje akademike, për të cilën Drejtuesi i Departamentit dhe Dekani i Fakultetit marrin masat disiplinore.

- j) Në raste paqartësish, studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të lektorit të kursit, për të marrë sqarimet e duhura. Për sqarime të mëtejshme ata kanë të drejtë t'i drejtohen me shkrim Drejtuesit të Departamentit që mbulon kursin përkatës.
- k) Kur studenti në provim vlerësohet me notën 4 (katër) ose "NP" (Nuk u paraqit), ai ka të drejtën të regjistrohet për të shlyer këtë lëndë vetëm në semestrin e verës, sezonin e riprovimeve në dimër.
- l) Regjistrimi në këtë rast do të bëhet sipas rregullit të përgjithshëm të regjistrimit të përcaktuar në nenin 77 të rregullores së Univeritetit "Ismail Qemali" Vlorë.
- m) Mesatarja e studentit llogaritet si mesatare e ponderuar. Shuma e produkteve të notave përfundimtare me kreditet përkatëse të lëndës pjestohet me totalin e kredive. (Bazuar në Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë neni 68, miratuar nga Senati Akademik me Vendim nr.57, datë 06.09.2018, i ndryshuar me vendim Nr 75, datë 19.11.2018, vendim Nr 5 datë 04.02.2019, vendim Nr 11, datë 27.02.2019.).

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, akordon për studentët në përfundim të studimeve titujt e nderit në tre nivele, në bazë të mesatares së përgjithshme të notave si më poshtë:

- 4. 8.00-8.89, cum laude
- 5. 8.90-9.39, magna cum laude
- 6. 9.40-10.00, summa cum laude

Këta tituj lëshohen së bashku me diplomën universitare të fituar nga studenti.


Neni 9

Sistemi i vlerësimit

Bazuar në Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë neni 68, miratuar nga Senati Akademik me Vendim nr.57, datë 06.09.2018, i ndryshuar me vendim Nr 75, datë 19.11.2018, vendim Nr 5 datë 04.02.2019, vendim Nr 11, datë 27.02.2019, Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, neni 60. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10. Nota më e ulët kaluese është nota 5 (pesë). Në procesverbalet evlerësimit përfundimtar për studentin jo kalues (ngelës) vendoset nota 4 (katër). Në të gjitha format e kontrollit të dijes përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht kthehet në notë.

Neni 10

Administrimi i dokumentacionit të provimeve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- a) Në fund të çdo provimi, testet dhe çdo material i provimit dorëzohet në sekretarinë e Departamentit të Biznesit, mbyllet në një zarf mbi të cilin të jenë shkruar të gjitha të dhënat e nevojshme dhe firmosen nga lektori.
- b) Zarfet me testet e provimeve të arkivuara në sekretarinë e departamentit, mund të hapen dhe të kontrollohen vetëm në rast ankimi ose shihet e arsyeshme nga autoritetet drejtuese. Këto materiale ruhen deri në fund të provimeve të semestrit pasardhës e më pas ato digjen.
- c) Ndalohet hyrja në provim e personave të jashtëm, me përjashtim të përgjegjësit të departamentit, autoriteteve drejtuese të fakultetit e personave të tjerë të autorizuar me shkrim nga Dekani ose Rektori për të kryer kontroll.
- d) Departamenti i Biznesit mund të propozojë ndërtimin e një Komisioni për mbikqyrjen e procesit të provimeve.

Neni 11

Ankimi për rezultatin përfundimtar


- a) Bazuar në nenin 62, të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim Drejtuesit të Departamentit brenda 48 orëve nga marrja në dijeni e rezultatit të provimit, i cili bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vëmendëherë në dijeni Dekanin.
- b) Dekani, brenda 48 orësh nga marrja dijeni për ankesën nga Drejtuesi i Departamentit, ngre një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të Dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit.
- c) Ndryshimet në rezultatet e studentëve pasqyrohen në procesverbalin e ri të firmosur nga komisioni i cili i bashkëlidhet procesverbalit të mëparshëm dhe në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Univlora (SMI-Univlora).

Neni 12

Përmirësimi i notës

Bazuar në nenin 63, të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

- a) Studentët e ciklit të dytë kanë të drejtë të përmirësojnë notën në çdo lëndë, por jo më shumë se dy përmirësime në një vit akademik.
- b) Përmirësimet e notës bëhen vetëm në semestrin e verës, sezonin e riprovimeve të dimrit si dhe në datat e përcaktura nga Dekani i Fakultetit para mbrojtjes së diplomës, kundrejt një tarife të miratuar. Është detyra e tij të regjistrohet në kurset që do të përmirësojë notën, pasi më parë ka bërë kërkesën në sekretarinë e departamentit, e cila e përcjell informacionin tek Drejtoria e IT-së për të mundur aksesin e studentit në regjistrimin e kursit. Kërkesa bëhet të pakten 10 ditë para fillimit të semestrit të verës, sezonit të riprovimeve të dimrit dhe mbrojtjes së diplomes.
- c) Studenti ka të drejtë të kërkojë përmirësimin e notës së një lënde jo më shumë se një herë.
- d) Studentët duhet të jenë në dijeni se mbetet në fuqi nota e përsëritjes së fundit, e cila do të pasqyrohet në transkriptin e notave që tregon ecurinë akademike të studentit, pavarësisht nëse kjo është nota më e lartë apo jo.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- e) Nëse nota e përsëritjes së fundit është 4 (katër) rregullat akademike për shlyerjen e detyrimeve nuk ndryshojnë.
- f) Në listën e notave që shoqërojnë diplomën do të pasqyrohen vetëm notat përfundimare kaluese (5,6,7,8,9,10).

Neni 13

Praktika profesionale

Bazuar në nenin 64, të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.


- a) Studentët kanë të detyrueshme kryerjen e praktikës profesionale, kur ajo përfshihet në programin e studimit. Me fillimin e vitit akademik, departamenti u komunikon studentëve kohën e kryerjes, programin, mënyrën e zhvillimit dhe shlyerjes së saj.
- b) Praktikë profesionale zhvillohen në institucione sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga departamenti përkatës. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit ku kryen këtë proces.
- c) Gjatë kryerjes së praktikës profesionale, personeli akademik që drejton atë, ushtron kontroll të vazhdueshëm dhe mban lidhje me qendrën ku ajo kryhet. Në përfundim të praktikës profesionale, studentit përgatit një relacion për punën e kryer e cila vlerësohet nga pedagogu që e drejton praktikën pasi merr edhe mendimin e qendrës ku është kryer ajo. Vlerësimi bëhet me notë.
- d) Studentët të cilët i transferojnë studimet nga IAL-të tjera në Universitetin "Ismail Qemali" të Vlorës, por kanë lëndën e praktikës mësimore të vlerësuar Fitues/Jofitues dhe jo me notë, janë të detyruar që të zhvillojnë provimin e lëndës "Praktikë mësimore" por jo ta frekuentojnë atë.

Neni 14

Diplomimi

Bazuar në nenin 65, të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

- a) Në përfundim të kursit të plotë të studimeve "Master Profesional" në "Marketing", studentët kanë të drejtë të diplomohen. Kërkesat e diplomimit janë paraqitur në kurrikulën e programit të studimi "Master Profesional" në "Marketing".
- b) Sekretaria mësimore e Departamentit të Biznesit është e detyruar t'i përcjellë me shkresë të veçantë Drejtuesit të Departamentit dhe Dekanit të Fakultetit listën e studentëve që kanë plotësuar detyrimet e programit të studimi dhe çdo detyrim tjetër financiar të cilët kanë të drejtën e mbrojtjes së tezës së diplomës. Sekretaria mësimore mban përgjegjësi për saktësinë e të dhënave.
- c) Drejtuesi i Departamentit pas marrjes së listës së studentëve ngrë një komision ad-hoc, i cili verifikon nëse këta studentë kanë plotësuar detyrimet e programit të studimit. Pas verifikimit lista e studentëve që kanë të drejtën e mbrojtjes së tezës së diplomës, e firmosur nga anëtarët e komisionit, i përcillet përgjegjësit të departamentit.
- d) Në përfundim të programit të studimeve të ciklit të dytë, për fitimin e diplomës parashikohet një provim me gojë ose përgatitja e një teme diplome në varësi të notës mesatare të studentit deri në përfundim të semestrit të parafundit. Nota mesatare minimale që i jep të drejtën



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- studentit që mbrojtjen e diplomës ta ketë me provim përfundimtar apo tezë diplome propozohet nga departamenti dhe miratohet nga Senati Akademik.
- e) Për fitimin e diplomave të ciklit të dytë të studimeve parashikohet përgatitja e një teze diplome, të përpunuar në mënyrë krijuese e të pavarur nga studenti.
 - f) Drejtuesit e temave të diplomës miratohen nga drejtuesi i departamentit (referuar nenit 6 shkronja "g" të rregullores së programit).
 - g) Mbrojtja e diplomës bëhet e hapur. Procedura e mbrojtjes përfshin një provim me goje ose përgatitja e një temë diplome. Në përfundim juria bazuar në vlerësimin e udhëhëqësit dhe punimin e studentit, bën vlerësimin me notë. Juria dhe kryetari i saj miratohet nga Dekani i Fakultetit me propozim të Drejtuesit të Departamentit dhe përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë. Shlyerja e detyrimeve të programit të studimit dhe çdo detyrimi tjetër financiar dhe material kundrejt universitetit, është kusht paraprak për kryerjen e mbrojtjes së tezës së diplomës.
 - h) Drejtuesi i Departamentit i përcjellë Dekanit të Fakultetit listën e studentëve të diplomuar. Dekani nëpërmjet një shkrese ia përcjellë këtë listë Zyrës së Regjistrimit për të përgatitur diplomatat përkatëse.
 - i) Në raste të veçanta kur studentët pengohen për t'u diplomuar vetëm për një lëndë të cilën e kanë frekuentuar dhe kanë vlerësimin me notën 4 (katër) ose shënimin "NP", Dekani i Fakultetit cakton data të posaçme për këto provime, përpara datës së përcaktuar për mbrojtjen e tezës së diplomës.
 - j) Diplomimi në këtë program studimi të ciklit të dytë bëhet në fund të vitit akademik, datat dhe afatet përcaktohen nga Dekani i Fakultetit, duke mos krijuar pengesa në kohë për studentët që diplomohen.
 - k) Kandidati që rrëzohet në mbrojtjen e diplomës, ka të drejtë të riparaqitet për mbrojtje në një datë të caktuar nga Dekani i Fakultetit në semestrin pasardhës.

Neni 15

Procedura e provimit të diplomës

- a) Bazuar në Vendimin e Senatit Akademik nr. 9, datë 26.01.2017, në shkresën nr. 532/1 Prot., datë 10.04.2017, të Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, provimi i diplomimit të studentëve të Ciklit të Dytë të Studimeve Master Profesional të cilët nuk plotësojnë kriterin e notës mesatare 8.5 (tetë e pesë të dhjetat), do të zhvillohet me gojë.
- b) Pyetjet për ciklin e dytë të studimeve Master Profesional "Marketing" do të jenë nga lëndët me kodin MKT, përveç atyre me zgjedhje, të planit mësimor përkatës.
- c) Pyetjet do të dorëzohen me firmë nga të gjithë pedagogët që zhvillojnë lëndën dhe do të protokollohen.
- d) Banka e të gjitha pyetjeve do t'u vihet në dispozicion studentëve të paktën 2 muaj para provimit të diplomimit, sipas mënyrës së parashikuar në Rregulloren e Univesitetit "Ismail Qemali" për dhënien e informacionit.
- e) Numri i pyetjeve në një tezë do të jetë tre.
- f) Tezat do të përgatiten ditën e provimit nga Komisioni i Provimit dhe do të firmosen nga Drejtuesi i Departamentit dhe nga Dekani.
- g) Studenti ka të drejtë ta ndërrojë tezën deri në dy herë dhe për cdo ndërrim teze do t'i ulen dy nota.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- h) Studentit do t'i jepet mundësia të përgatitet për tezën përkatëse për 20 minuta, dhe pas këtij afati të lënë në dispozicion të tij, studenti do të përgjigjet me gojë për pyetjet që përmban teza.
- i) Komisioni i Provimit të Diplomës përbëhet nga 5 anëtarë.
- j) Çdo anëtar i komisionit jep vlerësimin përkatës për cdo student, dhe vlerësimi final i studentit do të jetë mesatarja e thjeshtë aritmetike e vlerësimeve të 5 anëtarëve të Komisionit të Provimit të Diplomës.
- k) Të gjitha procedurat e tjera të diplomimit do të zhvillohen sipas rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe rregullores së Departamentit.

Neni 16
Pajisja me diplome


Bazuar në nenin 66, të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

- a) Studentët që kanë plotësuar detyrimet e programit të studimit dhe çdo detyrim tjetër financiar dhe material kundrejt universitetit pajisen me diplomë e cila është një dokument zyrtar.
- b) Diplomat e Programit të Ciklit të Dytë të studimeve "Master Profesional" në "Marketing" shoqërohet me listën e Notave (në listën e notave që shoqërojnë diplomën pasqyrohen vetëm notat përfundimtare kaluese ≥ 5 të çdo lënde) dhe me suplementin e diplomës. Suplementi i Diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e hapësirës europiane të arsimit të lartë. Ai përshkruan në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve që janë kryer dhe përfunduar me sukses nga mbajtësi i diplomës.
- c) Përmbajtja dhe forma e diplomës është e përcaktuar në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Diploma nënshkruhet prej Dekanit të Fakultetit Ekonomik dhe Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Për secilin prej tyre shënohet emri, mbiemri, grada dhe titulli shkencor. Nënshkrimi i Rektorit shoqërohet me vulën e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
- d) Për këtë program të ciklit të dytë të studimeve lëshohet diploma: Diplomë "Master Profesional" në "Marketing".

Neni 17
Tërheqja e diplomës

Bazuar në nenin 67, të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

- a) Tërheqja e diplomës bëhet personalisht nga i diplomuari, kundrejt nënshkrimit dhe evidentohet në regjistrin përkatës.
- b) Nëse prania e të diplomuarit është objektivist e pamundur, tërheqjen e diplomës mund t'a bëjë një nga pjesëtarët e familjes, i pajisur me prokurë të posaçme e cila bashkëngjitet në regjistrin e tërheqjes së diplomave, duke paraqitur dhe një dokument identifikimi të tij.
- c) Nëse diploma nuk është plotësuar në rregull, i interesuari duhet të mos e tërheq atë dhe të kërkojë pajisjen me diplomë të rregullt. Nëse i interesuari e tërheq diplomën e parregullt, në rast se i humbet origjinali ose i dëmtohet duke iu bërë i papërdorshëm, universiteti nuk lëshon dublikatë. Lejohet vetëm dhënia e listës së notave të fituara dhe vërtetim me fotografi i cili është ekuivalent me diplomën, pasi nënshkruhet nga rektori i universitetit, Dekani dhe përgjegjësi i zyrës së regjistrimit. Nënshkrimet e tyre vërtetohen me vulën e Universitetit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

"Ismail Qemali" Vlorë. Diploma e plotësuar në mënyrë të parregullt, asgjësohet me një komision të përbërë prej tre anëtarësh të caktuar me urdhër të dekanit me hartimin e procesverbalit përkatës, i cili depozitohet në zyrën e regjistrimit, përpara se i interesuari të pajiset me vërtetim me fotografi ekuivalent me diplomën.

- d) Nëse një shtetas i diplomuar në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë rezulton me dy dokumente diplomimi, diplomë origjinale dhe vërtetim me fotografi ekuivalent me diplomën, do të quhet i vlefshëm dokumenti i lëshuar në datën më të vonë.
- e) Në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni të përgjithshme për të gjithë fakultetet në shkallë universiteti dhe dorëzimi i diplomave bëhet personalisht nga Rektori, në prani të përfaqësuesve të Senatit Akademik, të profesoratit, administratës dhe studentëve.

**KREU IV
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E STUDENTËVE**

**Neni 18
Të drejtat e studentëve**

Të drejtat dhe obligimet e studentëve janë të parashikuara në nenin 70 të Rregullores së UV, 2014, ndërsa shkeljet disiplinore nga studentët parashikohen në nenin 74 të po kësaj rregulloreje.

Studenti ka të drejtë:

- a. Të ndjekë leksione, seminare dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore, të organizuara në përputhje me statusin e tij.
- b. Të përdorë pajisjet, bazën materiale dhe laboratorike të universitetit sipas rregullave përkatëse, për të realizuar programin mësimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tij shkencor, bibliotekën dhe mjediset sportive e kulturore të universitetit.
- c. Të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet drejtuese, si në Senatin Akademik, në Këshillin e Administrimit, ku janë të regjistruar, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe Statutin e Universitetit.
- d. Të organizohet në shoqata të ndryshme jopolitike në përputhje me aktet ligjore e nënligjore përkatëse.
- e. Të përfitojë bursë studimi brenda ose jashtë shtetit kur plotëson kushtet e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, Senatit e në marrëveshjet ndërshtetërore ose ndëruniversitare.
- f. Të përfitojë shpërblime të veçanta që akordohen nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë sipas ligjit dhe kritereve të caktuara nga Senati Akademik.
- g. Të shprehë opinionin e tij për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të universitetit
- h. Të ankohet për shkelje të rregullave dhe standarteve akademike nga ana e pedagogëve, mosrealizimine procesit të mësimdhënies, rregullat për zhvillimin e provimit dhe për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

vlerësimin e tij të pamerituar.

- i. Të ankohet për shkelje të etikës akademike, të konfliktit të interesit dhe të çdo rasti tjetër që çënon integritetin e studentit.
- j. Të ndjekë studimet në një degë të dytë, në sistem të ndryshëm nga ai që ndjek, sipas përcaktimeve në këtë rregullore, në vendimet e Senatit apo në aktet e posaçme të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit.

Të drejta të tjera të studenteve janë përcaktuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në Statutin (2019) dhe në Rregulloren (2014) të UV.

Neni 19

Detyrimet e studentëve

Studenti është i detyruar:

- a. Të njohë me hollësi Statutin, Rregulloren e Universitetit dhe çdo Rregullore tjetër e detyrimet që lindin për të dhe të jetë i vetëdijshëm për zbatimin e tyre, në të kundërt, universiteti nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre.
- b. Të njohin të gjitha kërkesat e përgjithshme të universitetit, si dhe kërkesat specifike të programit në fushën që ata kanë zgjedhur. Studentët janë përgjegjës për t'iu përgjigjur të gjitha kërkesave dhe rregulloreve përkatëse në bazë të diplomave që ata synojnë.
- c. Të zbatojë të gjitha rregullat që rrjedhin nga Statuti i Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës, nga kjo rregullore dhe nga çdo akt tjetër ligjor e nënligjor për arsimin e lartë.
- d. Të respektojë Kodin e Etikës së universitetit.
- e. Të shlyejë detyrimet e përcaktuara në programin e studimit si dhe çdo detyrim tjetër financiar dhe material ndaj universitetit.
- f. Të shlyejë të gjitha detyrimet financiare të parashikuara në ligj.
- g. Të mbajë përgjegjësi për shkeljet e rregullave të universitetit nga ana e tij; dëmet materiale që ai mund të ketë bërë zhdëmtohen në masën e përlogaritur.


Detyra apo përgjegjësi të tjera të studentëve janë përcaktuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në Statutin (2019) dhe në Rregulloren (2014) e UV-së.

Neni 20

Përgjegjësi të tjera të studentëve

Përgjegjësitë e studentit përfshijnë ndër të tjera edhe pikat më poshtë:

- a. Studenti duhet të njohë dhe të respektojë rregullat e zhvillimit të orës së mësimi të përcaktuara në syllabus dhe të komunikuar në auditor nga pedagogu.
- b. Studenti duhet t'i drejtojë ankesat akademike në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor tek autoritetet drejtuese.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

- c. Studenti duhet të respektojë oraret e konsultimeve të komunikuara nga pedagogu.

Neni 21

Masat disiplinore per studentet

Shkelje e rregullave të universitetit konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që çënojnë personalitetin e personelit akademik, të çdo punonjësi tjetër të universitetit dhe çdo student, normat etiko-morale të shoqërisë si kopjimi në provime, falsifikimi i dokumentave të ndryshme, fyerjet, sharjet, aktet e rrugaçërisë, të vjedhjes etj., kur këto veprime nuk bartin elementë të veprës penale. Ndaj studentit që kryen këto veprime, merren këto masa disiplinore:

- Vërejtje me shkrim;
- Paralajmerim për pezullim ose përjashtim nga universiteti;
- Pezullimin nga universiteti për një semester ose një vit;
- Përjashtim nga universiteti "Ismail Qemali" Vlorë;
- Përjashtim përgjithmonë nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë.

Vendimin për "Vërejtje me shkrim", "Paralajmërim për pezullim ose përjashtim nga universiteti" dhe "Pezullim nga universiteti për një semester ose një vit" e merr dekanati përkatës. Në raste të veçanta të parashikuara në Kodin e Etikës këto vendime mund të merren nga Rektorati.

Vendimin për "Përjashtimin nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë" (heqje vetëm e së drejtës së studimit të filluar) dhe "Përjashtimin përgjithmonë nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë (duke mos i lejuar të fitojë të drejta studimi të mëpasshme) e merr Rektorati i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, mbi bazën e propozimit të dekanatit.

Studenti konsiderohet i rehabilituar, nëse nuk bën shkelje tjetër me kalimin e tre muajve për vërejtjen, brenda gjashtë muajve për paralajmërimin dhe një viti për pezullimin.


KREU V
KOMUNIKIMI

Neni 22

Rregullat e sjelljes akademike

Të gjithë anëtarët e komunitetit akademik në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë duhet të praktikojnë dhe të ruajnë standartet e integritetit akademik dhe ndershmërisë. Integritet akademik do të thotë të paraqesësh vetveten dhe punën tënde me ndershmëri. Më poshtë janë disa shembuj pandershmërie akademike:

- Mashttrim në provime. Këtu përfshihet: përdorimi i materialeve si libra dhe/ose shënime në formë të printuar apo elektronike kur një gjë e tillë nuk është e autorizuar nga pedagogu, kopjimi nga testimi apo detyra e dikujt tjetër, lejimi i dikujt tjetër për të kopjuar punën tënde,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

zëvendësimi i punës tände me punën e dikujt tjetër, ose të tjera forma shkeljesh në sjellje gjatë provimeve.

- b. Plagjiaturë e punës së të tjerëve. Plagjiaturë do të thotë të përdorësh punën ose idetë e dikujt tjetër duke i konsideruar ato të veta.
- c. Falsifikimi i dokumentave apo paraqitja dizinformuese e kredencialeve të një personi është shkelje.

Pedagogët duhet të respektojnë standartet e mëposhtme në kontekstin e sjelljes akademike:

- a. Të informojnë dhe të udhëzojnë studentët mbi procedurat dhe standartet e punës kërkimore, si dhe mbi dokumentacionin e kërkuar për të kryer detyra në një kurs të caktuar apo në kontekstin e një disipline të caktuar.
- b. Të ndërmarrin hapa konkretë për të dalluar dhe parandaluar mashtrimin.
- c. Të raportojnë sjelljen akademike të dyshuar jo etike tek dekani.
- d. Të paraqesin evidencë të plagjiaturës, të mashtrimit në provime apo raporte laboratorit, të falsifikimeve të dokumentave apo të tjera forma sjelljeje të pandershme akademike në autoritetet drejtuese përkatëse.

Studentët duhet të respektojnë standartet e mëposhtme në kontekstin e sjelljes akademike:

- a. Të jenë në dijeni të praktikave dhe standardeve të shkollimit të ndershëm.
- b. Të ndjekin udhëzimet e pedagogëve në lidhje me provimet dhe detyrat në mënyrë që të evitojnë një paraqitje të keqe të punës.
- c. Të jenë të sigurt që rregulla të veçanta në lidhje me dokumentimin e detyrave të kursit, të procedurave të provimit, të përdorimit të informacioneve e programeve kompjuterike, etj., janë kuptuar qartë.
- d. Të evitojnë aparencën e mashtrimit (të lënit përshtypje sikur po mashtrojnë). Nëse studentët janë të bindur që praktikën e përdorura nga pedagogu janë të favorshme ndaj mashtrimit, ata mund t'i përcjellin këtë mesazh Drejtuesit të Departamentit, Dekanit ose t'i drejtohen me ankesë të drejtëpërdrejtë Rektorit. Raste të tilla do të gjykohen dhe vlerësohen sipas rregulloreve në fuqi.

Neni 23

Normat etike gjatë komunikimit Personel Akademik – Student

Gjatë veprimtarisë së mësimdhënies shpesh vihen re problematika rreth koordinimit të punës së stafit me studentët. Për këtë qëllim kjo Rregullore sugjeron të ndiqen disa udhëzime praktike të miratuara si më poshtë:

- a. Studenti është i detyruar të zbatojë e respektojë Kodin e Etikës të miratuar në UV.
- b. Kontakti i pedagogut me studentin për aspekte të mësimdhënies apo kërkimit shkencor do të bëhet vetëm në ambientet e auditoreve, laboratoreve dhe në asnjë rast jashtë tij.
- c. Komunikimi me studentin mund të bëhet në rrugë elektronike në adresën e pedagogut e cila është regjistruar më parë në departament.
- d. Justifikimet nga ana e studentëve tek pedagogu për mungesat gjatë vitit pranohen vetëm pas dorëzimit të raporteve të marrë nga komisione të posacëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- e. Në rast të vonesave të pedagogut në auditor studenti duhet të presë disa minuta dhe nëse pedagogu nuk ka njoftuar paraprakisht ai mund të largohet.
- f. Në auditor, laboratorë si dhe gjatë provimit nuk lejohet përdorimi i mjeteve të komunikimit.
- g. Në ditën e provimit studenti respekton me përpikmëri datën, vendin e provimit, si dhe siguron mjetet e nevojshme (stilolaps, makinë llogaritëse, mjet identifikimi).
- h. Në ambjentet e provimit nuk lejohet prania e familjarëve të studentit përveçse personave të autorizuar nga ana e Drejtuesit të Departamentit (pedagogë, sekretare).
- i. Pedagogu ju'a komunikon notën studentëve duke respektuar konfidencialitetin (në mungesë të sistemit) ose bën verifikime të vlerësimit në një orar e sallë të caktuar.

Për komunikime të pedagogut me studentët që kanë tema diplome hartohet një grafik i konsultimit në një sallë e ditë të caktuar javore.

Neni 24

Çështje akademike

Çdo njësi akademike duhet të respektojë procedurat për zgjidhjen e ankesave, në lidhje me vlerësimin, standartin dhe cilësinë e mësimdhënies, situatat brenda në klasë dhe çdo problem tjetër akademik. Për rastet e ankesave në lidhje me vlerësimin, ndiqet ajo procedurë e përcaktuar në nenin 62 të rregullores së UV.

Neni 25

Çështje jo akademike

Personeli i universitetit dhe studentët mund të hasin situata problematike gjatë kohës së punës apo të studimeve në universitetin "Ismail Qemali" Vlorë në të cilat mund të perfshihen rastet e fyerjeve, sharjeve, konfrontimeve fizike. Qëndrimi diskriminues apo ngacmimi seksual, sharjet apo fyerjet raciale, sharjet për orientimin seksual, për ngjyrën, fenë, bindjet, origjinën kombëtare apo prejardhjen, gjendjen martesore, gjendjen familjare etj., kërkojnë vëmendje të veçantë në zgjidhjen e tyre.

KREU VI

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 26

Çdo çështje që lind nga zbatimi i kësaj rregulloreje dhe nuk mbulohet prej saj, rregullohet me Rregulloren e Brendshme të Universitetit. Në rast se edhe kjo e fundit nuk e mbulon, atëherë Departamenti i propozon Rektorit dhe Senatit Akademik propozimin përkatës për miratim.

Asambleja e Departamentit të Biznesit ka të drejtën dhe detyrimin e rishikimit periodik të kësaj rregulloreje, dhe përcjelljen për miratim në Senatin Akademik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË


UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

RREGULLORE E PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT

“MASTER PROFESIONAL” në “SIPËRMARRJE dhe TURIZËM”

Departamenti i Biznesit

Dhjetor 2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Baza ligjore**

Kjo rregullore bazohet në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Udhëzimin e MASR, për çeljen e Programeve të Studimit, Statutit (2019) dhe Rregullores (2014) të Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës.


**Neni 2
Misioni dhe objektivat**

- Rregullorja synon të krijojë një kuadër të plotë dhe të qartë për programin e ciklit të dytë të studimit "Master Profesional" në "Sipërmarrje dhe Turizëm", si dhe të përcaktoj rregulla standarte të përgatitjes, organizimit dhe administrimit të studentëve të këtij cikli.
- Kjo rregullore i bashkangjitet Rregullores së Brendshme të Departamentit të Biznesit dhe shtrin efektin e saj mbi njësinë mësimore - shkencore përgjegjëse për organizimin e Programit të Ciklit të dytë "Master Profesional" në "Sipërmarrje dhe Turizëm".
- Ky program studimi përfshihet në ciklin e dytë të studimeve universitare të ofruara prej Departamentit të Biznesit, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë dhe siguron Diplomë Universitare "Master Profesional" në "Sipërmarrje dhe Turizëm".

**KREU II
ORGANIZMI I PROGRAMIT TE STUDIMIT**

**Neni 3
Programi i studimit**

Programi i studimit "Master Profesional" në "Sipërmarrje dhe Turizëm" siguron Diplomë Universitare "Master Profesional" në "Sipërmarrje dhe Turizëm". Ky program organizohet dhe shprehet përmes grumbullimit të krediteve sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS). Për të fituar këtë diplomë nevojiten 60 kredite (ECTS). 60 kredite (ECTS) përfaqësojnë ngarkesën e punës së një viti akademik studimesh, aq sa është edhe kohëzgjatja e këtij programi studimesh.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- a) Viti akademik është njësia kohore bazë e studimeve. Një vit akademik përbëhet nga 2 semestra dhe shtrihet në intervalin nga 30 deri 40 javë mësimore, sipas udhëzimeve MASR (30 javë mësim dhe 6-8 javë provime dhe provim formimi / mbrojtje teze diplome). Fillimi dhe përfundimi i vitit akademik përcaktohet me Udhezim të MASR në çdo fillim viti akademik.
- b) Çdo semestër zgjat 15 javë për mësim dhe mesatarisht 3-4 javë për provime. Organizimi i vitit akademik, datat e fillimit të semestrave dhe sezoni i provimeve, shpallen nga rektori në fillim të viti akademik.
- c) Në fillim të çdo viti akademik, mbështetur në kurrikulat e programeve të studimit, departamentet përcjellin planin mësimor për miratim tek Dekani i Fakultetit dhe Rektori. Për çdo kurs hartohen programet mësimore (syllabus).
- d) Me fillimin e vitit akademik, Departamenti shpall orarin mësimor: ditën, orën, sallën dhe personelin akademik përkatës, për semestrin përkatës.
- e) Moduli themelor i studimit është lënda semestrare me kredite (ECTS) të bashkangjitura në planin mësimor të miratuar të programit të studimit.
- f) Numri i caktuar i kredive fitohet pas përfundimit me sukses të disiplinës, siç është përshkruar në këtë Rregullore dhe në Rregulloren e Brendshme të Universitetit.
- g) Vlerësimi i studentëve bëhet nga personeli akademik përkatës që zhvillon disiplinat mësimore, i cili organizon sipas gjykimit të tij kontrole me gojë, me shkrim, ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë, detyra të pavarura, detyra kursi etj., në përputhje me mënyrat e vlerësimit të përcaktuara në këtë Rregullore dhe në Rregulloren e Brendshme të Universitetit.
- h) Studenti përfundon studimet në këtë program studimi dhe merr diplomë kur ka likujduar me sukses gjithë disiplinat mësimore të parashikuara në planin mësimor përkatës, ka mbrojtur me sukses tezën e diplomës / provimin e formimit, kjo në varësi të notës mesatare që arrin studentit gjatë të dy semestrave të studimit, dhe ka fituar 60 kredite (ECTS). Këto dy forma vlerësimi përmbajnë tematika të lëndëve të drejtimit që ka ndjekur në program, me qëllim krijimin dhe vlerësimin e dijeve të fituara në disiplina të ndryshme.

xi. Tematika e temës së diplomës

Tema e diplomës mund të jetë bibliografike, kërkimore apo dhe kombinim i të dyjave për çështje që lidhen me disiplinat mësimore të planit mësimor të programit të studimit.

Miratimi i udhëheqësit të diplomës dhe fushës së studimit bëhet në departament me propozim të udhëheqësit pasi ky i fundit ka diskutuar dhe dakortësuar me studentin.

Zgjedhja e temës së diplomës duhet të bëhet nga studentin dhe të jetë aprovuar nga udhëheqësi i tij/saj shkencor.

Realizimi me sukses i punimit kërkon angazhim maksimal të studentit, i cili duhet të zhvillojë kontakte të vazhdueshme dhe të raportojë në mënyrë sistematike tek udhëheqësi punën e kryer sipas një skeduli të përcaktuar paraprakisht.

Tema e diplomës duhet të përfaqësojë një punë kërkimore shkencore origjinale dhe të mos jetë paraqitur në ndonjë institucion tjetër arsimor.

Studenti duhet të përcaktojë qartë metodologjinë kërkimore (induktive apo deduktive) të studimit në varësi të kontekstit të studimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Struktura e temës duhet të jetë e qartë dhe duhet të zbatohet pavarësisht tipit të metodologjisë së përzgjedhur në të.

Përmbajtja e temës së diplomës duhet të paraqesi një vështrim të literaturës së huaj dhe të asaj vendase, e cila tregon se studenti e njeh mirë fushën e tij kërkimore dhe është në gjendje të paraqesi koncepte teorike, të analizojë dhe të krahasojë zhvillimin e modeleve teorike nga autorë të huaj apo vendas.

Gjithashtu, vështrimi i literaturës duhet të përmbajë paraqitje dhe krahasime të rezultateve të punimeve empirike të autorëve të huaj dhe vendas të kohëve më të fundit dhe të pasqyrojë hendekun që ekziston në literaturë nën kontestin e vendit tonë.

Një pasqyrë e përgjithshme e variablave të marrë në studim duhet të bëhet për Shqipërinë për të evidentuar dhe kuptuar më mirë ecurinë e variablave në kohë dhe evidentimin e problematikave të tyre (nëse ka).

Zgjedhja e tipit të të dhënave dhe aplikimi i metodave të duhura kërkimore është një mundësi për të dëshmuar pjekurinë e tij/saj akademike dhe aftësinë për të aplikuar punë kërkimore në të ardhme.

Mbyllja e punimit kërkimor shkencor realizohet me nxjerrjen e konkluzioneve dhe dhënien e sugjerimeve për grupet e ndryshme të interesit.

Shkrimi i temës së diplomës i mundëson studentit të mësojë gjëra të reja për veten e tij/saj, për shembull, për kapacitetin, perceptimin, kreativitetin, këmbënguljen dhe mënyrën e të punuarit.

xii. Forma dhe volumi i tezës së diplomës

Punimi i diplomës për ciklin e dytë të studimit Master Profesional duhet të ketë një numër faqesh minimalisht prej 50 faqe. Kriteret e punimit të temës së diplomës dhe formati i saj duhet të jetë konform Vendimit të Këshillit të Fakultetit me Nr 190 Prot datë 02.07.2014.

xiii. Diagrama kohore

Studentit që i lind e drejta për tu diplomuar me temë diplome, në fillim të semestrit përkatës, por jo më vonë se java e dytë, aplikon në sekretari për temë diplome duke plotësuar një formular ku propozon udhëheqësin e temës së diplomës. Ky i fundit miratohet nga drejtuesi i departamentit jo më vonë se java e katërt. Udhëheqësi i diplomës dorëzon një deklaratë ku të dy palët (udhëheqësi dhe studenti) kanë rënë dakort për të punuar së bashku mbi fushën e studimit të përzgjedhur, jo më vonë se java e tretë e semestrit. Afati i dorëzimit të punimit të temës së diplomës është një javë para datës së provimit të diplomës.

xiv. Detyrime të pedagogut udhëheqës

- Të dorëzojë në kohë propozimet për studentët që merr përsipër të udhëheqë, si dhe fushën e studimit..
- Orientime dhe takime këshilluese në periudha të rregullta kohore me studentët. T'u ofrojë studentëve udhëzime për shkrimin dhe mbrojtjen e temës si dhe për vlerësimin e saj.

xv. Vlerësimi

- Tema e diplomës vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash përpara një komisioni të ngritur në Departament.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- i) Kohëzgjatja maksimale e studimeve nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimit që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën kur student i ka pezulluar studimet. Studenti mund të përfundojë studimet e plota dhe të mbrojë diplomën, brenda afatit të rregullt të studimeve ose tej kufirit që parashikon ky afat, por duke iu nënshtruar detyrimeve që lindin nga kohëzgjatja e studimeve përtej kohës normale.
- j) Bazuar në Nenin 45 "Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies" të Rregullores së Universitetit, në ciklin e dytë të studimeve master, semestret e vjeshtës dhe pranverës kanë të njëjtën kohëzgjatje, por me specifikën që programi i një disipline mund të realizohet jo domosdoshmërisht për një periudhë 15-javore, bazuar në burimet njerëzore të brendshme dhe të jashtme që ofron universiteti dhe në varësi të kushteve të tjera. Kjo nënkupton që plani mësimor semestral mund realizohet, duke bërë një organizim të mësimdhënies dhe shpërndarje të disiplinave përgjatë tij, që do të thotë se mësimdhënia në një disiplinë mund të fillojë në një nga javët e semestrit dhe të përfundojë pasi të realizohet programi me ngarkesën mësimore përkatëse të leksioneve, seminareve, laboratoreve apo formave të tjera të mësimdhënies.
- k) Në fillim të çdo viti akademik, mbështetur në planet mësimore të miratuara për vitin akademik për çdo program studimi, bazuar në burimet njerëzore të brendshme dhe të jashtme që ofron departamenti/fakulteti/universiteti dhe në varësi të kushteve të tjera, departamentet hartojnë planin mësimor të sugjeruar të vitit akademik, i cili miratohet nga Dekani i Fakultetit
- l) Kohëzgjatja e orës së mësimit është 50 minuta.

Neni 4

**Pranimi i studentëve në Programin e Ciklit të Dytë të studimeve "Master Profesional" në
"Sipërmarrje dhe Turizëm"**


Pranimi i studentëve në Programin e Ciklit të Dytë të studimeve "Master Profesional" në "Sipërmarrje dhe Turizëm", në Universitetin "Ismail Qemali" Vlore, realizohet bazuar në nenin 76 të Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në udhëzimet e përvitshme të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në vetë kriteret e parashikuara në nenin 39 të rregullores së UV si dhe në kriteret e propozuara nga njësitë bazë dhe të miratuara nga SA i Institucionit.

Neni 5

Ndërprerja e studimeve

Studenti mund të ndërpresë studimet në çdo kohë të vitit, për një afat jo më tepër se një vit dhe vetëm për këto raste:

- a) Kur sëmuret për periudha të gjata, të dokumentuara me raport nga komisioni mjekoligjor, ku të jenë shprehur qartë diagnoza e rekomandimi (jo nga mjeku i familjes).
- b) Kur mbetet kryefamiljar, në raste fatkeqësish e në kushte ekonomike të vështira, të dokumentuara nga zyrat përkatëse.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Në çdo rast dokumentat duhet të paraqiten përpara se të ndërpresë studimet, të shoqëruara me një kërkesë drejtuar Rektoratit. Studentët të cilët ndërpresin studimet për dy ose më shumë semestra radhë dhe nuk kanë marrë lejen nga rektori për këtë ndërprerje duhet të aplikojnë përsëri për pranim në universitet.

Neni 6

Transferimi i studimeve, njohja e krediteve dhe ekuivalentimi i lëndëve

Është e mundur njohja e plotë dhe e pjesshme e krediteve të studentëve që vijnë me transferim nga programe të tjera studimi brenda ose dhe jashtë universitetit. Pranë Departamentit ngrihet Komisioni i Njohjes dhe Ekuivalentimit i cili vlerëson dokumentacionin e studentit të përcjellë nga Sekretaria Mësimore dhe bën njohjen e krediteve përkatëse për disiplinat mësimore të likujduara për të cilën kërkohet njohja e krediteve. Modalitetet dhe procedurat për transferimin e studentëve janë të përcaktuara në Kreun VI të Rregullores së Brendshme të Universitetit.


KREU III

RREGULLAT E NDJEKJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE PROCEDURAT E DIPLOMIT

Neni 7

Frekuentimi dhe shlyerja e detyrimeve të lëndëve

- Frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm deri në masën 75%.
- Numri i mungesave të lejuara përlllogaritet për gjithë semestrin përkundëjt numrit total të orëve në semester.
- Çdo pedagog pajiset me regjistrin përkatës i cili përmban informacion mbi veprimtarinë e mësimdhënies dhe frekuentimit. Pedagogu përgjigjet drejtpërdrejt për saktësinë e informacionit mbi frekuentimin.
- Nëse studenti mungon gjatë zhvillimit të kursit dhe tejkalon numrin total të mungesave të lejuara për gjithë semestrin (jo më pak se 75 % frekuentim), atëherë studenti skualifikohet për shkak të mungesave, nuk futet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet mungesë (m) dhe përsërit kursin në semestrin e ardhshëm kur kursi ofrohet. Shënimi mungesë (m) do të pasqyrohet në procesverbalet përfundimtare nëse studenti ka plotësuar mungesat totale.
- Nëse studenti ka frekuentuar kursin por nuk paraqitet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet "Np - Nuk u paraqit". Nëse studenti nuk ka detyrime frekuentimi, por nuk është paraqitur në asnjë prej provimeve të pjesshme duke përfshirë dhe provimin final, në procesverbalin përfundimtar të vlerësimit do të bëhet shënimi "NP" (Nuk u paraqit), në të kundërt do të bëhet vlerësimi me notën përkatëse. Studentët nuk kane detyrimin dhe nuk mund të regjistrohen në këto lëndë për të ndjekur kursin si përsëritës, por kanë të drejtën të shlyejnë lëndën vetëm me provim final, sipas përcaktimeve në këtë rregullore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK


- f. Sekretaria mësimore e Departamentit të Biznesit përgjigjet për administrimin e informacionit mbi detyrimet akademike të studentëve në këtë program studimi.

Neni 8

Rregullat e zhvillimit të provimeve dhe vlerësimi i lëndës

Bazuar në nenet 60-65 të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

- a) Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet, me shkrim, me gojë ose i kombinuar me shkrim e me gojë, duke u mbështetur në programin mësimor.
- b) Kontrolli i dijeve në këtë program studimi të ciklit të dytë realizohet përgjatë semestrit nëpërmjet një provimi final gjithëpërfshirës si dhe formave të tjera të vlerësimit nëse janë parashikuar në syllabus-in e lëndës.
- c) Orari i provimeve finale duhet të shpallet para përfundimit të semestrit. Për semestrin e verës dhe sezonin e riprovimeve të dimrit kontrolli i dijeve realizohet vetëm nëpërmjet një provimi final.
- d) Rregulla apo specifika të provimeve, pesha (përqindja) e secilit provim apo detyre në vlerësimin përfundimtar, literatura, temat ose pjesët e programit të lëndës për çdo provim, dita apo java e provimit, ora dhe salla e zhvillimit, referencat e konvertimit të pikëve në notë etj., përcaktohen në syllabus-in e lëndës të hartuar nga pedagogu dhe u bëhet i ditur studentëve që ndjekin atë kurs.
- e) Pesha (përqindja) e formave të tjera të vlerësimit, të parashikuara në syllabus-in e lëndës, detyra kursi, projekte individuale, etj., janë jo më shumë se 10-15% e vlerësimit të përgjithshëm, të gjitha së bashku.
- f) Në rastin kur studenti nuk merr pjesë në një provim, por paraqet dokumentacion ku justifikon arsye të forta si probleme shëndetësore serioze (psh. shtrim në spital, aksident të rëndë), raste të jashtëzakonshme fatkeqësish familjare, apo raste urgjencash publike, vendimin për një mundësi tjetër për dhënien e provimit e merr Dekani i Fakultetit të Ekonomisë, duke u bazuar në kërkesën me shkrim të paraqitur nga studenti. Dekani ka të drejtë të kërkojë dokumentacion shtesë për të verifikuar mungesën.
- g) Kurset janë të gjitha semestrare. Nëse studenti nuk kualifikohet, pra ka shënim mungesë (m) në proceverbalin përfundimtar të kursit, ai ka të drejtën dhe detyrimin ta frekuentojë përsëri atë kurs, në semestrat pasardhës kur kursi ofrohet. Nëse kursi për arsye të ndryshme nuk do të ofrohet më (p.sh. për arsye të ndryshimeve në kurrikula), studenti ka të drejtë të frekuentojë atë kurs që mund të ekuivalentohej me kursin që nuk ofrohet më, ose në rast të kundërt hapet kursi që nuk ofrohet më pavarësisht numrit të studentëve, vetëm për studentët që janë brenda afatit maksimal të studimeve të tyre, në zbatim të Vendimit të Senatit Akademik Nr. 10, dt. 07.02.2019. Krahas kurseve të përcaktuara në planet semestrare, studenti ka të drejtë të frekuentojë njëkohësisht edhe kurse të tjera për të cilat ka shënimin mungesë (m) nga semestri paraardhës, por duke respektuar rregullat e numrit të krediteve të regjistruara në një semestër dhe rregullat e përgjithshme të regjistrimit, sipas nenit 77 të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
- h) Tezat e provimit në të gjitha kontrollet hartohen nga titullari i lëndës. Kompromentimi i tezës është përgjegjësi direkte e pedagogut.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË SENATI AKADEMIK

- i) Pas përfundimit të çdo provimi apo formave të tjera të kontrollit të dijeve, rezultatet editohen në sistemin elektronik të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, jo më larg se 48 orë nga data e zhvillimit të tij. Nëse pedagogu zhvillon provime të njëpasnjëshme për secilën prej tyre duhet të respektohet 48 orëshi për editimin e rezultateve në sistemin elektronik. Një ditë pas shpalljes së rezultateve, pranohen dhe vlerësohen ankesat e studentëve dhe në mbyllje të këtij procesi, printohet procesverbali nga sistemi, firmoset nga lektori dhe dorëzohet në sekretarinë mësimore. Në rast se pedagogu në mënyrë të pajustificuar, nuk ka edituar rezultatet e provimeve në sistem, konsiderohet shkelje akademike, për të cilën Drejtuesi i Departamentit dhe Dekani i Fakultetit marrin masat disiplinore.
- j) Në raste paqartësish, studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të lektorit të kursit, për të marrë sqarimet e duhura. Për sqarime të mëtejshme ata kanë të drejtë t'i drejtohen me shkrim Drejtuesit të Departamentit që mbulon kursin përkatës.
- k) Kur studenti në provim vlerësohet me notën 4 (katër) ose "NP" (Nuk u paraqit), ai ka të drejtën të regjistrohet për të shlyer këtë lëndë vetëm në semestrin e verës, sezonin e riprovimeve në dimër.
- l) Regjistrimi në këtë rast do të bëhet sipas rregullit të përgjithshëm të regjistrimit të përcaktuar në nenin 77 të rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
- m) Mesatarja e studentit llogaritet si mesatare e ponderuar. Shuma e produkteve të notave përfundimtare me kreditet përkatëse të lëndës pjesëtohet me totalin e kredive. (Bazuar në Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë neni 68, miratuar nga Senati Akademik me Vendim nr.57, datë 06.09.2018, i ndryshuar me vendim Nr 75, datë 19.11.2018, vendim Nr 5 datë 04.02.2019, vendim Nr 11, datë 27.02.2019,).

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, akordon për studentët në përfundim të studimeve titujt e nderit në tre nivele, në bazë të mesatares së përgjithshme të notave si më poshtë:

- 7. 8.00-8.89, cum laude
- 8. 8.90-9.39, magna cum laude
- 9. 9.40-10.00, summa cum laude

Këta tituj lëshohen së bashku me diplomën universitare të fituar nga studenti.

Neni 9

Sistemi i vlerësimit

Bazuar në Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë neni 68, miratuar nga Senati Akademik me Vendim nr.57, datë 06.09.2018, i ndryshuar me vendim Nr 75, datë 19.11.2018, vendim Nr 5 datë 04.02.2019, vendim Nr 11, datë 27.02.2019, Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, neni 60. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10. Nota më e ulët kaluese është nota 5 (pesë). Në procesverbalet evlerësimit përfundimtar për studentin jo kalues (ngelës) vendoset nota 4 (katër). Në të gjitha format e kontrollit të dijes përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht kthehet në notë.

Neni 10

Administrimi i dokumentacionit të provimeve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- a) Në fund të çdo provimi, testet dhe çdo material i provimit dorëzohet në sekretarinë e Departamentit të Biznesit, mbyllet në një zarf mbi të cilin të jenë shkruar të gjitha të dhënat e nevojshme dhe firmosen nga lektori.
- b) Zarfet me testet e provimeve të arkivuara në sekretarinë e departamentit, mund të hapen dhe të kontrollohen vetëm në rast ankimi ose shihet e arsyeshme nga autoritetet drejtuese. Këto materiale ruhen deri në fund të provimeve të semestrit pasardhës e më pas ato digjen.
- c) Ndalohej hyrja në provim e personave të jashtëm, me përjashtim të përgjegjësit të departamentit, autoriteteve drejtuese të fakultetit e personave të tjerë të autorizuar me shkrim nga Dekani ose Rektori për të kryer kontroll.
- d) Departamenti i Biznesit mund të propozojë ndërtimin e një Komisioni për mbikqyrjen e procesit të provimeve.

Neni 11

Ankimi për rezultatin përfundimtar

- a) Bazuar në nenin 62, të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim Drejtuesit të Departamentit brenda 48 orëve nga marrja në dijeni e rezultatit të provimit, i cili bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vëmendëherë në dijeni Dekanin.
- b) Dekani, brenda 48 orësh nga marrja dijeni për ankesën nga Drejtuesi i Departamentit, ngre një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të Dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit.
- c) Ndryshimet në rezultatet e studentëve pasqyrohen në procesverbalin e ri të firmosur nga komisioni i cili i bashkëlidhet procesverbalit të mëparshëm dhe në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Univlora (SMI-Univlora).

Neni 12

Përmirësimi i notës

Bazuar në nenin 63, të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

- a) Studentët e ciklit të dytë kanë të drejtë të përmirësojnë notën në çdo lëndë, por jo më shumë se dy përmirësime në një vit akademik.
- b) Përmirësimet e notës bëhen vetëm në semestrin e verës, sezonin e riprovimeve të dimrit si dhe në datat e përcaktura nga Dekani i Fakultetit para mbrojtjes së diplomës, kundrejt një tarife të miratuar. Është detyra e tij të regjistrohet në kurset që do të përmirësojë notën, pasi më parë ka bërë kërkesën në sekretarinë e departamentit, e cila e përcjell informacionin tek Drejtoria e IT-së për të mundur aksesin e studentit në regjistrimin e kursit. Kërkesa bëhet të pakten 10 ditë para fillimit të semestrit të verës, sezonit të riprovimeve të dimrit dhe mbrojtjes së diplomes.
- c) Studenti ka të drejtë të kërkojë përmirësimin e notës së një lënde jo më shumë se një herë.
- d) Studentët duhet të jenë në dijeni se mbetet në fuqi nota e përsëritjes së fundit, e cila do të pasqyrohet në transkriptin e notave që tregon ecurinë akademike të studentit, pavarësisht nëse kjo është nota më e lartë apo jo.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- e) Nëse nota e përsëritjes së fundit është 4 (katër) rregullat akademike për shlyerjen e detyrimeve nuk ndryshojnë.
- f) Në listën e notave që shoqërojnë diplomën do të pasqyrohen vetëm notat përfundimare kaluese (5,6,7,8,9,10).

Neni 13

Praktika profesionale

Bazuar në nenin 64, të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

- a) Studentët kanë të detyrueshme kryerjen e praktikës profesionale, kur ajo përfshihet në programin e studimit. Me fillimin e vitit akademik, departamenti u komunikon studentëve kohën e kryerjes, programin, mënyrën e zhvillimit dhe shlyerjes së saj.
- b) Praktikën profesionale zhvillohen në institucione sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga departamenti përkatës. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit ku kryen këtë proces.
- c) Gjatë kryerjes së praktikës profesionale, personeli akademik që drejton atë, ushtron kontroll të vazhdueshëm dhe mban lidhje me qendrën ku ajo kryhet. Në përfundim të praktikës profesionale, studentit përgatit një relacion për punën e kryer e cila vlerësohet nga pedagogu që e drejton praktikën pasi merr edhe mendimin e qendrës ku është kryer ajo. Vlerësimi bëhet me notë.
- d) Studentët të cilët i transferojnë studimet nga IAL-të tjera në Universitetin "Ismail Qemali" të Vlorës, por kanë lëndën e praktikës mësimore të vlerësuar Fitues/Jofitues dhe jo me notë, janë të detyruar që të zhvillojnë provimin e lëndës "Praktikë mësimore" por jo ta frekuentojnë atë.

Neni 14

Diplomimi

Bazuar në nenin 65, të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

- a) Në përfundim të kursit të plotë të studimeve "Master Profesional" në "Sipërmarrje dhe Turizëm", studentët kanë të drejtë të diplomohen. Kërkesat e diplomimit janë paraqitur në kurrikulën e programit të studimi "Master Profesional" në "Sipërmarrje dhe Turizëm".
- b) Sekretaria mësimore e Departamentit të Biznesit është e detyruar t'i përcjellë me shkresë të veçantë Drejtuesit të Departamentit dhe Dekanin të Fakultetit listën e studentëve që kanë plotësuar detyrimet e programit të studimi dhe çdo detyrim tjetër financiar të cilët kanë të drejtën e mbrojtjes së tezës së diplomës. Sekretaria mësimore mban përgjegjësi për saktësinë e të dhënave.
- c) Drejtuesi i Departamentit pas marrjes së listës së studentëve ngre një komision ad-hoc, i cili verifikon nëse këta studentë kanë plotësuar detyrimet e programit të studimit. Pas verifikimit lista e studentëve që kanë të drejtën e mbrojtjes së tezës së diplomës, e firmosur nga anëtarët e komisionit, i përcillet përgjegjësit të departamentit.
- d) Në përfundim të programit të studimeve të ciklit të dytë, për fitimin e diplomës parashikohet një provim me gojë ose përgatitja e një teme diplome në varësi të notës mesatare të studentit deri në përfundim të semestrit të parafundit. Nota mesatare minimale që i jep të drejtën studentit që mbrojtjen e diplomës ta ketë me provim përfundimtar apo tezë diplome propozohet nga departamenti dhe miratohet nga Senati Akademik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- e) Për fitimin e diplomave të ciklit të dytë të studimeve parashikohet përgatitja e një teze diplome, të përpunuar në mënyrë krijuese e të pavarur nga studenti.
- f) Drejtuesit e temave të diplomës miratohen nga drejtuesi i departamentit (referuar nenit 6 shkronja "g" të rregullores së programit).
- g) Mbrojtja e diplomës bëhet e hapur. Procedura e mbrojtjes përfshin një provim me gojë ose përgatitja e një temë diplome. Në përfundim juria bazuar në vlerësimin e udhëhëqësit dhe punimin e studentit, bën vlerësimin me notë. Juria dhe kryetari i saj miratohet nga Dekani i Fakultetit me propozim të Drejtuesit të Departamentit dhe përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë. Shlyerja e detyrimeve të programit të studimit dhe çdo detyrim tjetër financiar dhe material kundrejt universitetit, është kusht paraprak për kryerjen e mbrojtjes së tezës së diplomës.
- h) Drejtuesi i Departamentit i përcjellë Dekanit të Fakultetit listën e studentëve të diplomuar. Dekani nëpërmjet një shkrese ia përcjellë këtë listë Zyrës së Regjistrimit për të përgatitur diplomatat përkatëse.
- i) Në raste të veçanta kur studentët pengohen për t'u diplomuar vetëm për një lëndë të cilën e kanë frekuentuar dhe kanë vlerësimin me notën 4 (katër) ose shënimin "NP", Dekani i Fakultetit cakton data të posaçme për këto provime, përpara datës së përcaktuar për mbrojtjen e tezës së diplomës.
- j) Diplomimi në këtë program studimi të ciklit të dytë bëhet në fund të vitit akademik, datat dhe afatet përcaktohen nga Dekani i Fakultetit, duke mos krijuar pengesa në kohë për studentët që diplomohen.
- k) Kandidati që rrëzohet në mbrojtjen e diplomës, ka të drejtë të riparaqitet për mbrojtje në një datë të caktuar nga Dekani i Fakultetit në semestrin pasardhës.

Neni 15

Procedura e provimit të diplomës

- a) Bazuar në Vendimin e Senatit Akademik nr. 9, datë 26.01.2017, në shkresën nr. 532/1 Prot., datë 10.04.2017, të Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, provimi i diplomimit të studenteve të Ciklit të Dytë të Studimeve Master Profesional të cilët nuk plotësojnë kriterin e notës mesatare 8.5 (tetë e pesë të dhjetat), do të zhvillohet me gojë.
- b) Pyetjet për ciklin e dytë të studimeve Master Profesional "Sipërmarrje dhe Turizëm" do të jenë nga lëndët me kodin MKT, përvec atyre me zgjedhje, të planit mësimor përkatës.
- c) Pyetjet do të dorëzohen me firmë nga të gjithë pedagogët që zhvillojnë lëndën dhe do të protokollohen.
- d) Banka e të gjitha pyetjeve do t'u vihet në dispozicion studentëve të paktën 2 muaj para provimit të diplomimit, sipas mënyrës së parashikuar në Rregulloren e Univesitetit "Ismail Qemali" për dhënien e informacionit.
- e) Numri i pyetjeve në një tezë do të jetë tre.
- f) Tezat do të përgatiten ditën e provimit nga Komisioni i Provimit dhe do të firmosen nga Drejtuesi i Departamentit dhe nga Dekani.
- g) Studenti ka të drejtë ta ndërrojë tezën deri në dy herë dhe për cdo ndërrim teze do t'i ulen dy nota.
- h) Studentit do t'i jepet mundësia të përgatitet për tezën përkatëse për 20 minuta, dhe pas këtij afati të lënë në dispozicion të tij, studenti do të përgjigjet me gojë për pyetjet që përmban teza.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- i) Komisioni i Provimit të Diplomës përbëhet nga 5 anëtarë.
- j) Çdo anëtar i komisionit jep vlerësimin përkatës për çdo student, dhe vlerësimi final i studentit do të jetë mesatarja e thjeshtë aritmetike e vlerësimeve të 5 anëtarëve të Komisionit të Provimit të Diplomës.
- k) Të gjitha procedurat e tjera të diplomimit do të zhvillohen sipas rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe rregullores së Departamentit.

Neni 16

Pajisja me diplomë

Bazuar në nenin 66, të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

- a) Studentët që kanë plotësuar detyrimet e programit të studimit dhe çdo detyrim tjetër financiar dhe material kundrejt universitetit pajisen me diplomë e cila është një dokument zyrtar.
- b) Diplomat e Programit të Ciklit të Dytë të studimeve "Master Profesional" në "Sipërmarrje dhe Turizëm" shoqërohet me listën e Notave (në listën e notave që shoqërojnë diplomën pasqyrohen vetëm notat përfundimtare kaluese ≥ 5 të çdo lënde) dhe me suplementin e diplomës. Suplementi i Diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e hapësirës europiane të arsimit të lartë. Ai përshkruan në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve që janë kryer dhe përfunduar me sukses nga mbajtësi i diplomës.
- c) Përmbajtja dhe forma e diplomës është e përcaktuar në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Diploma nënshkruhet prej Dekanit të Fakultetit Ekonomik dhe Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Për secilin prej tyre shënohet emri, mbiemri, grada dhe titulli shkencor. Nënshkrimi i Rektorit shoqërohet me vulën e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
- d) Për këtë program të ciklit të dytë të studimeve lëshohet diploma: Diplomë "Master Profesional" në "Sipërmarrje dhe Turizëm".

Neni 17

Tërheqja e diplomës

Bazuar në nenin 67, të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

- a) Tërheqja e diplomës bëhet personalisht nga i diplomuari, kundrejt nënshkrimit dhe evidentohet në regjistrin përkatës.
- b) Nëse prania e të diplomuarit është objektivisht e pamundur, tërheqjen e diplomës mund t'a bëjë një nga pjesëtarët e familjes, i pajisur me prokurë të posaçme e cila bashkëngjitet në regjistrin e tërheqjes së diplomave, duke paraqitur dhe një dokument identifikimi të tij.
- c) Nëse diploma nuk është plotësuar në rregull, i interesuari duhet të mos e tërheq atë dhe të kërkojë pajisjen me diplomë të rregullt. Nëse i interesuari e tërheq diplomën e parregullt, në rast se i humbet origjinali ose i dëmtohet duke iu bërë i papërdorshëm, universiteti nuk lëshon dublikatë. Lejohet vetëm dhënia e listës së notave të fituara dhe vërtetim me fotografi i cili është ekuivalent me diplomën, pasi nënshkruhet nga rektori i universitetit, Dekani dhe përgjegjësi i zyrës së regjistrimit. Nënshkrimet e tyre vërtetohen me vulën e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Diploma e plotësuar në mënyrë të parregullt, asgjësohet me një komision të përbërë prej tre anëtarësh të caktuar me urdhër të dekanit me hartimin e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

procesverbalit përkatës, i cili depozitohet në zyrën e regjistrimit, përpara se i interesuari të pajiset me vërtetim me fotografi ekuivalent me diplomën.

- d) Nëse një shtetas i diplomuar në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë rezulton me dy dokumente diplomimi, diplomë origjinale dhe vërtetim me fotografi ekuivalent me diplomën, do të quhet i vlefshëm dokumenti i lëshuar në datën më të vonë.
- e) Në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni të përgjithshme për të gjithë fakultetet në shkallë universiteti dhe dorëzimi i diplomave bëhet personalisht nga Rektori, në prani të përfaqësuesve të Senatit Akademik, të profesoratit, administratës dhe studentëve.


**KREU IV
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E STUDENTËVE**

**Neni 18
Të drejtat e studentëve**

Të drejtat dhe obligimet e studentëve janë të parashikuara në nenin 70 të Rregullores së UV, 2014, ndërsa shkeljet disiplinore nga studentët parashikohen në nenin 74 të po kësaj rregulloreje.

Studenti ka të drejtë:

- a. Të ndjekë leksione, seminare dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore, të organizuara në përputhje me statusin e tij.
- b. Të përdorë pajisjet, bazën materiale dhe laboratorike të universitetit sipas rregullave përkatëse, për të realizuar programin mësimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tij shkencor, bibliotekën dhe mjediset sportive e kulturore të universitetit.
- c. Të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet drejtuese, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe Statutin e Universitetit.
- d. Të organizohet në shoqata të ndryshme jopolitike në përputhje me aktet ligjore e nënligjore përkatëse.
- e. Të përfitojë bursë studimi brenda ose jashtë shtetit kur plotëson kushtet e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, Senatit e në marrëveshjet ndërshtetërore ose ndëruniversitare.
- f. Të përfitojë shpërblime të veçanta që akordohen nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë sipas ligjit dhe kritereve të caktuara nga Senati Akademik.
- g. Të shprehë opinionin e tij për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të universitetit.
- h. Të ankohet për shkelje të rregullave dhe standarteve akademike nga ana e pedagogëve, mosrealizimin e procesit të mësimdhënies, rregullat për zhvillimin e provimit dhe për vlerësimin e tij të pamerituar.
- i. Të ankohet për shkelje të etikës akademike, të konfliktit të interesit dhe të çdo rasti tjetër që çënon integritetin e studentit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- j. Të ndjekë studimet në një degë të dytë, në sistem të ndryshëm nga ai që ndjek, sipas përcaktimeve në këtë rregullore, në vendimet e Senatit apo në aktet e posaçme të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit.

Të drejta të tjera të studenteve janë përcaktuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në Statutin (2019) dhe në Rregulloren (2014) të UV.

Neni 19

Detyrimet e studentëve

Studenti është i detyruar:

- Të njohë me hollësi Statutin, Rregulloren e Universitetit dhe çdo Rregullore tjetër e detyrimet që lindin për të dhe të jetë i vetëdijshëm për zbatimin e tyre, në të kundërt, universiteti nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre.
- Të njohin të gjitha kërkesat e përgjithshme të universitetit, si dhe kërkesat specifike të programit në fushën që ata kanë zgjedhur. Studentët janë përgjegjës për t'ju përgjigjur të gjitha kërkesave dhe rregulloreve përkatëse në bazë të diplomave që ata synojnë.
- Të zbatojë të gjitha rregullat që rrjedhin nga Statuti i Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës, nga kjo rregullore dhe nga çdo akt tjetër ligjor e nënligjor për arsimin e lartë.
- Të respektojë Kodin e Etikës së univeristetit.
- Të shlyejë detyrimet e përcaktuara në programin e studimit si dhe çdo detyrim tjetër financiar dhe material ndaj universitetit.
- Të shlyejë të gjitha detyrimet financiare të parashikuara në ligj.
- Të mbajë përgjegjësi për shkeljet e rregullave të universitetit nga ana e tij; dëmet materiale që ai mund të ketë bërë zhdëmtohen në masën e përllogaritur.

Detyra apo përgjegjësi të tjera të studentëve janë përcaktuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në Statutin (2019) dhe në Rregulloren (2014) e UV-së.

Neni 20

Përgjegjësi të tjera të studentëve

Përgjegjësitë e studentit përfshijnë ndër të tjera edhe pikat më poshtë:

- Studenti duhet të njohë dhe të respektojë rregullat e zhvillimit të orës së mësimi të përcaktuara në syllabus dhe të komunikuar në auditor nga pedagogu.
- Studenti duhet t'i drejtojë ankesat akademike në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor tek autoritetet drejtuese.
- Studenti duhet të respektojë oraret e konsultimeve të komunikuar nga pedagogu.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Neni 21

Masat disiplinore për studentët

Shkelje e rregullave të universitetit konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që çenojnë personalitetin e personelit akademik, të çdo punonjësi tjetër të universitetit dhe çdo studenti, normat etiko-morale të shoqërisë si kopjimi në provime, falsifikimi i dokumentave të ndryshme, fyerjet, sharjet, aktet e rugaçërisë, të vjedhjes etj., kur këto veprime nuk bartin elementë të veprës penale. Ndaj studentit që kryen këto veprime, merren këto masa disiplinore:

- a) Vërejtje me shkrim;
- b) Paralajmërim për pezullim ose përjashtim nga universiteti;
- c) Pezullimin nga universiteti për një semester ose një vit;
- d) Përjashtim nga universiteti "Ismail Qemali" Vlorë;
- e) Përjashtim përgjithmonë nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë.

Vendimin për "Vërejtje me shkrim", "Paralajmërim për pezullim ose përjashtim nga universiteti" dhe "Pezullim nga universiteti për një semester ose një vit" e merr dekanati përkatës. Në raste të veçanta të parashikuara në Kodin e Etikës këto vendime mund të merren nga Rektorati.

Vendimin për "Përjashtimin nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë" (heqje vetëm e së drejtës së studimit të filluar) dhe "Përjashtimin përgjithmonë nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë (duke mos i lejuar të fitojë të drejta studimi të mëpasshme) e merr Rektorati i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, mbi bazën e propozimit të dekanatit.

Studenti konsiderohet i rehabilituar, nëse nuk bën shkelje tjetër me kalimin e tre muajve për vërejtjen, brenda gjashtë muajve për paralajmërimin dhe një viti për pezullimin.

**KREU V
KOMUNIKIMI**

Neni 22

Rregullat e sjelljes akademike

Të gjithë anëtarët e komunitetit akademik në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë duhet të praktikojnë dhe të ruajnë standartet e integritetit akademik dhe ndershmërisë. Integritet akademik do të thotë të paraqesësh vetveten dhe punën tënde me ndershmëri. Më poshtë janë disa shembuj pandershmërie akademike:

- a. Mashtrim në provime. Këtu përfshihet: përdorimi i materialeve si libra dhe/ose shënime në formë të printuar apo elektronike kur një gjë e tillë nuk është e autorizuar nga pedagogu, kopjimi nga testimi apo detyra e dikujt tjetër, lejimi i dikujt tjetër për të kopjuar punën tënde,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

zëvendësimi i punës tënde me punën e dikujt tjetër, ose të tjera forma shkeljesh në sjellje gjatë provimeve.

- b. Plagjiaturë e punës së të tjerëve. Plagjiaturë do të thotë të përdorësh punën ose idetë e dikujt tjetër duke i konsideruar ato të veta.
- c. Falsifikimi i dokumentave apo paraqitja dizinformuese e kredencialeve të një personi është shkelje.

Pedagogët duhet të respektojnë standartet e mëposhtme në kontekstin e sjelljes akademike:

- a. Të informojnë dhe të udhëzojnë studentët mbi procedurat dhe standartet e punës kërkimore, si dhe mbi dokumentacionin e kërkuar për të kryer detyra në një kurs të caktuar apo në kontekstin e një disipline të caktuar.
- b. Të ndërmarrin hapa konkretë për të dalluar dhe parandaluar mashtrimin.
- c. Të raportojnë sjelljen akademike të dyshuar jo etike tek dekan.
- d. Të paraqesin evidencë të plagjiaturës, të mashtrimit në provime apo raporte laborator, të falsifikimeve të dokumentave apo të tjera forma sjelljeje të pandershme akademike në autoritetet drejtuese përkatëse.

Studentët duhet të respektojnë standartet e mëposhtme në kontekstin e sjelljes akademike:

- a. Të jenë në dijeni të praktikave dhe standardeve të shkollimit të ndershëm.
- b. Të ndjekin udhëzimet e pedagogëve në lidhje me provimet dhe detyrat në mënyrë që të evitojnë një paraqitje të keqe të punës.
- c. Të jenë të sigurt që rregulla të veçanta në lidhje me dokumentimin e detyrave të kursit, të procedurave të provimit, të përdorimit të informacioneve e programeve kompjuterike, etj., janë kuptuar qartë.
- d. Të evitojnë aparencën e mashtrimit (të lënë përshtypje sikur po mashtrojnë). Nëse studentët janë të bindur që praktikat e përdorura nga pedagogu janë të favorshme ndaj mashtrimit, ata mund t'i përcjellin këtë mesazh Drejtuesit të Departamentit, Dekanit ose t'i drejtohen me ankesë të drejtëpërdrejtë Rektorit. Raste të tilla do të gjykohen dhe vlerësohen sipas rregulloreve në fuqi.

Neni 23

Normat etike gjatë komunikimit Personel Akademik - Student

Gjatë veprimtarisë së mësimdhënies shpesh vihen re problematika rreth koordinimit të punës së stafit me studentët. Për këtë qëllim kjo Rregullore sugjeron të ndiqen disa udhëzime praktike të miratuara si më poshtë:

- a) Studenti është i detyruar të zbatojë e respektojë Kodin e Etikës të miratuar në UV.
- b) Kontakti i pedagogut me studentin për aspekte të mësimdhënies apo kërkimit shkencor do të bëhet vetëm në ambientet e auditoreve, laboratoreve dhe në asnjë rast jashtë tij.
- c) Komunikimi me studentin mund të bëhet në rrugë elektronike në adresën e pedagogut e cila është regjistruar më parë në departament.
- d) Justifikimet nga ana e studentëve tek pedagogu për mungesat gjatë vitit pranohen vetëm pas dorëzimit të raporteve të marrë nga komisione të posacëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- e) Në rast të vonesave të pedagogut në auditor studenti duhet të presë disa minuta dhe nëse pedagogu nuk ka njoftuar paraprakisht ai mund të largohet.
- f) Në auditor, laboratorë si dhe gjatë provimit nuk lejohet përdorimi i mjeteve të komunikimit.
- g) Në ditën e provimit studenti respekton me përpikmëri datën, vendin e provimit, si dhe siguron mjetet e nevojshme (stilolaps, makinë llogaritëse, mjet identifikimi).
- h) Në ambjentet e provimit nuk lejohet prania e familjarëve të studentit përveçse personave të autorizuar nga ana e Drejtuesit të Departamentit (pedagogë, sekretare).
- i) Pedagogu ju'a komunikon notën studentëve duke respektuar konfidencialitetin (në mungesë të sistemit) ose bën verifikime të vlerësimit në një orar e sallë të caktuar.

Për komunikime të pedagogut me studentët që kanë tema diplome hartohet një grafik i konsultimit në një sallë e ditë të caktuar javore.

Neni 24

Çështje akademike

Çdo njësi akademike duhet të respektojë procedurat për zgjidhjen e ankesave, në lidhje me vlerësimin, standartin dhe cilësinë e mësimdhënies, situatat brenda në klasë dhe çdo problem tjetër akademik. Për rastet e ankesave në lidhje me vlerësimin, ndiqet ajo procedurë e përcaktuar në nenin 62 të rregullores së UV.

Neni 25

Çështje jo akademike

Personeli i universitetit dhe studentët mund të hasin situata problematike gjatë kohës së punës apo të studimeve në universitetin "Ismail Qemali" Vlorë në të cilat mund të perfshihen rastet e fyerjeve, sharjeve, konfrontimeve fizike. Qëndrimi diskriminues apo ngacmimi seksual, sharjet apo fyerjet raciale, sharjet për orientimin seksual, për ngjyrën, fenë, bindjet, origjinën kombëtare apo prejardhjen, gjendjen martesore, gjendjen familjare etj., kërkojnë vëmendje të veçantë në zgjidhjen e tyre.

KREU VI

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 26

Çdo çështje që lind nga zbatimi i kësaj rregulloreje dhe nuk mbulohet prej saj, rregullohet me Rregulloren e Brendshme të Universitetit. Në rast se edhe kjo e fundit nuk e mbulon, atëherë Departamenti i propozon Rektorit dhe Senatit Akademik propozimin përkatës për miratim. Asambleja e Departamentit të Biznesit ka të drejtën dhe detyrimin e rishikimit periodik të kësaj rregulloreje, dhe përcjelljen për miratim në Senatin Akademik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

